



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 13

2000

Maj

PËRMBAJTJA

Ligj nr. 8606, datë 27.4.2000	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit", ndryshuar me ligjin nr.8458, datë 11.2.1999.....	567
Ligj nr.8607, datë 27.4.2000	Për "Statusin e Dëshmorit të Atdheut".....	568
Ligj nr.8608, datë 27.4.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Katolike në Shqipëri për ndërtimin dhe administrimin e spitalit "Zonja e Këshillit të Mirë".....	573
Dekret nr.2624, datë 12.5.2000	Për lënie të shtetësisë shqiptare.....	577
Vendim i Kuvendit Nr.437, datë 3.5.2000	Për zgjedhjen e dy anëtarëve të komisionit të shërbimit civil.....	578

Vendim i Kuvendit Nr.437/1, datë 3.5.2000	Për zgjedhjen e një anëtari të komisionit të shërbimit civil.....	579
Vendim i Kuvendit Nr.438, datë 3.5.2000	Për emërimin e inspektores së përgjithshme të Bankës së Shqipërisë.....	579
Vendim i Kuvendit Nr.439, datë 3.5.2000	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të RTSh-së.....	579
Vendim i KM Nr.150, datë 31.3.2000	Për miratimin e rregullave për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël, të autorizuar.....	580
Vendim i KM Nr.155, datë 7.4.2000	Për prokurimin e drejtpërdrejtë të fondeve për furnizimin me ushqim të efektivit të aparatit të Ministrisë së Rendit Publik dhe të efektivit që do të trajnohet në qendrën e trajnimit Durrës.....	605
Vendim i KM Nr.204, datë 29.4.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.627, datë 24.12.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Shqipërisë".....	606
Vendim i KM Nr.208, datë 29.4.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.651, datë 18.10.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve shtetërore".....	606
Vendim i KM Nr.211, datë 5.5.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.704, datë 7.11.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me shpërblim të ushtarakëve të sistemit të Rendit Publik, brigadës komando dhe policisë ushtarake".....	607
Vendim i KM Nr.213, datë 5.5.2000	Për përmirësimin e sistemit të ndriçimit të disa qyteteve.....	608
Vendim i KM Nr.216, datë 5.5.2000	Për shpërblimin e cilësisë së lartë sportive të peshëngritësve shqiptarë dhe për përgatitjen e tyre për lojrat olimpike "SIDNEY 2000".....	609
Vendim i KM Nr.217, datë 5.5.2000	Për Kontrollin Financiar.....	609
Vendim i KM Nr.224, datë 5.5.2000	Për shpronësimin dhe kompensimin e tokës bujqësore të familjeve të fshatrave Zallmner dhe Bulcesh, që përmythen nga ujëmbledhësi i Bovillës.....	613
Vendim i KM Nr.225, datë 5.5.2000	Për likuidimin në rrugë administrative të ndërmarrjes "Fonderia e uzinës mekanike", Tiranë, dhe përballimin e pagesës së punonjësve që mbeten pa punë nga likuidimi i saj.....	616
Vendim i KM Nr.226, datë 5.5.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.335, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit".....	618

Vendim i KM Nr.228, datë 5.5.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.731, datë 11.11.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Administrativ".....	618
Vendim i KM Nr.229, datë 5.5.2000	Për masën e mbulimit të çmimit të barnave që rimbursohen.....	619
Vendim i Gj.K, Nr.12	Me objekt "Shfuqizimin e nenit 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", pasi vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe me vetë ligjin".....	620

L I G J
Nr. 8606, datë 27.4.2000

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8081, DATË 7.3.1996 “PËR
VEPRIMTARITË E SIGURIMIT DHE TË RISIGURIMIT”, NDRYSHUAR ME LIGJIN
NR.8458, DATË 11.2.1999**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8081, datë 7.3.1996 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit”, ndryshuar me ligjin nr.8458, datë 11.2.1999 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 23 ndryshohet si vijon:

“Shoqëritë e sigurimit dhe/ose të risigurimit duhet të kenë një kapital themeltar, pa përfshirë kontributet në natyrë, jo më të vogël se shumata e përcaktuara sipas grupeve të sigurimit:

a) 100 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtarinë në një ose më shumë prej grupeve 10 deri në 15 (përfshirë grupin 15) të shtojcës së këtij ligji;

b) 60 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtarinë në një ose më shumë prej grupeve 1 deri në 8 (përfshirë grupin 8) dhe 16 e 18 të shtojcës së këtij ligji;

c) 50 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtarinë në një ose më shumë prej grupeve 9 dhe/ose 17 të shtojcës së këtij ligji;

ç) 120 milionë lekë, nëse shoqëria ushtron veprimtarinë për sigurimin e jetës në një ose më shumë prej grupeve 19 deri 22 (përfshirë grupin 22).

Kapitali themeltar i shoqërisë së sigurimit duhet të përbëhet, të paktën në dy të tretat e tij, prej mjeteve monetare. Çdo aksioner duhet të derdhë për llogari të shoqërisë, në krijim e sipër, në njërin nga bankat tregtare të nivelit të dytë që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, në mjete monetare jo më pak se gjysmën e kontributit të nënshkruar prej tij.”

Neni 2

Pas nenit 23 shtohet neni 23/1 me këtë përmbajtje:

“Shoqëritë, të cilat janë pajisur me autorizim zyrtar për ushtrimin e veprimtarisë siguroese dhe/ose risiguroese, brenda tre viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të arrijnë kufijtë e kapitalit themeltar, të përcaktuar në nenin 23, si vijon:

a) 50 milionë lekë në fund të vitit të parë;

b) 60 milionë lekë në fund të vitit të dytë;

c) 100 milionë lekë në fund të vitit të tretë.”

Neni 3

Paragrafi i dytë i nenit 28 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 33, pas pikës 5, shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Të japë informacion për origjinën e kapitalit. Për origjinën e kapitalit Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve ka të drejtë të kërkojë të dhëna nga autoritetet përgjegjëse të shtetit të origjinës.”

Neni 5

Shkronja “a” e nenit 65 ndryshohet si vijon:

“a) të jenë të pajisura me zotësinë për të kryer operacione sigurimi, në mbështetje të legjislacionit të shtetit të origjinës dhe të kenë ushtruar veprimtari të paktën prej 5 vjetësh.”

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2617, datë 11.5.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J **Nr. 8607, datë 27.4.2000**

STATUSI I DËSHMORIT TË ATDHEUT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË **V E N D O S I:**

Neni 1

Në nderim të të rënëve në luftën për liri dhe pavarësi të Shqipërisë, miratohet “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i cili përcakton nocionin, kriteret, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tij.

Neni 2

Statusi i Dëshmorit të Atdheut u njihet:

a) personave të rënë në luftë për liri dhe pavarësi kombëtare para 28 nëntorit 1912 dhe shtetasve shqiptarë që kanë rënë në luftë për mbrojtjen e integritetit territorial, të lirisë dhe pavarësisë të Shqipërisë para 7 prillit 1939;

b) shtetasve shqiptarë që kanë marrë pjesë me armë në dorë ose në formë të organizuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare (7 prill 1939 deri më 29 nëntor 1944) dhe kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre; që kanë vdekur për shkak të plagëve të marra në luftë ose janë ekzekutuar, ose kanë vdekur nga torturat në burgje e kampe

përqëndrimi nazifashiste deri më 9 maj 1945;

c) shtetasve shqiptarë, pjesëtarë të formacioneve ushtarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kanë rënë në luftën kundër pushtuesve nazifashistë jashtë kufijve shtetëror, deri më 9 maj 1945;

ç) shtetasve shqiptarë, pjesëmarrës në formacione të rregullta të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kanë vdekur për shkak të sëmundjeve, të të ftohtit ose të fatkeqësive të ndryshme, duke qenë në krye të detyrës luftarake deri më 9 maj 1945;

d) shtetasve shqiptarë, që kanë rënë duke luftuar për çlirimin e Kosovës nga pushtuesit serb në vitet 1998-1999;

dh) shtetasve shqiptarë që kanë rënë duke luftuar në Spanjë (1936-1939) ose në vende të tjera, të inkuadruar në formacionet e koalicionit antifashist, deri më 9 maj 1945 ose kanë vdekur nga plagët e marra në këtë luftë;

e) shtetasve shqiptarë që kanë rënë ose bien në krye të detyrës për mbrojtjen e integritetit territorial, për mbrojtjen e institucioneve shtetërore nga terrorizmi ose në luftë kundër bandave të armatosura dhe kundër krimit ndaj jetës së individit;

ë) shtetasve të huaj, pjesëtarë të formacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që kanë rënë duke luftuar kundër pushtuesve nazifashistë.

Neni 3

Për kërkimin dhe njohjen e Statusit të Dëshmorit të Atdheut vlejné dokumentet shtetërore, që e vërtetojnë atë.

Të gjitha vendimet e mbështetura në ligjet ose dekretet e organeve shtetërore të mëparshme për shpalljen “Dëshmor”, nuk janë objekt rishikimi. Personi i rënë në luftë dhe i shpallur “Dëshmor” konsiderohet “Dëshmor i Atdheut” në kuptim të këtij ligji.

Kërkesën për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” e bën familja e dëshmorit, organet shtetërore ose përfaqësues të shoqërisë civile.

Neni 4

Pranë Këshillit të Ministrave krijohet Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut, i cili vendos për njohjen ose jo të Statusit të Dëshmorit të Atdheut, në bazë të propozimit të bërë nga këshilli i qarkut.

Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë, 4 nga ministrinë dhe 2 nga shoqëria civile, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave. Kryetari caktohet nga Këshilli i Ministrave, ndërsa përfaqësuesit e ministrive janë në rang zëvendësministri.

Këshilli i Ministrave cakton një staf teknik të Komisionit. Ai mbledh propozimet e këshillave të qarqeve, paraqet në Komision propozimet e tyre dhe ndjek zbatimin e vendimeve të Komisionit.

Komisioni brenda 2 muajve nga krijimi i tij, harton rregulloren e funksionimit të tij dhe e paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave.

Komisioni merr vendime me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

Komisioni është komision i përhershëm, për funksionimin e të cilit Këshilli i Ministrave cakton fondin e shpenzimeve administrative brenda muajit janar të çdo viti.

Këshilli i Ministrave cakton një shpërblim për anëtarët e Komisionit.

Komisioni raporton para Këshillit të Ministrave, të paktën 1 herë në vit, për punën e bërë për Statusin e Dëshmorit të Atdheut.

Deri në krijimin e qarqeve, kompetencat e detyrat e këshillit të qarkut, për Statusin e Dëshmorit të Atdheut do t'i kryejné këshillat e rrethëve (Këshilli Bashkiak i Tiranës).

Neni 5

Kërkesa me dokumentet përkatëse paraqiten në këshillin e qarkut, ku ka vendbanimin

familja e dëshmorit.

Kundër vendimit të Komisionit, të interesuarit kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, brenda një muaji nga data e marrjes në dijeni për vendimin.

Neni 6

Dita përkujtimore e Dëshmorëve të Atdheut është 5 Maji.

Neni 7

Dëshmori i Atdheut prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut. Çdo dëshmor ka një varr në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut, të ngritura në territorin e qarkut. Në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në kryeqytet përfaqësohen të gjitha qarqet e Republikës së Shqipërisë.

Në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut nuk mund të varrosen persona të tjerë, që nuk kanë statusin e Dëshmorit të Atdheut.

Neni 8

Varrimi i Dëshmorit të Atdheut në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut bëhet me ceremoni zyrtare me arkivol të mbuluar me flamurin kombëtar.

Ceremonia organizohet dhe zhvillohet nga organet e pushtetit vendor, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.

Shpenzimet e varrimit të Dëshmorit të Atdheut përballohen nga buxheti i shtetit.

Ato përcaktohen çdo vit në buxhetin e Ministrisë së Pushtetit Vendor.

Neni 9

Në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në shenjë nderimi qëndron gjithmonë i ngritur flamuri kombëtar.

Neni 10

Ndërtimi, mirëmbajtja dhe ruajtja e Varrezave të Dëshmorëve të Atdheut bëhet nga shteti dhe përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Në shenjë nderimi për Dëshmorët e Atdheut, me vendim të këshillit të qarkut ose të bashkisë (komunës) ngrihen, mirëmbahen dhe ruhen lapidare, pllaka përkujtimore, përmendore etj., si dhe emërtohen mjedise dhe institucione publike.

Neni 12

Zhvendosja e përmendoreve, lapidareve, pllakave përkujtimore, si dhe e objekteve të tjera, që kanë lidhje me Dëshmorët e Atdheut, bëhet vetëm në raste të veçanta, kur këtë e kërkojnë interesa të lartë shtetërore.

Zhvendosja bëhet me vendim të këshillit të qarkut, ku ndodhet objekti. Ky këshill përballon edhe shpenzimet për zhvendosjen.

Objektet e mësipërme rivendosen në një mjedis publik të përshtatshëm, para se të fillojnë punimet në vendndodhjen e mëparshme të objektit.

Neni 13

Familjet e Dëshmorëve të Atdheut gëzojnë nderim e përkrahje të veçantë nga shteti. Ato përfitojnë shpërblim financiar mujor. Kriteret dhe masa e shpërblimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14

Në familjen e dëshmorit të atdheut bëjnë pjesë:

- Bashkëshorti ose bashkëshortja, fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat.

Neni 15

Familja e Dëshmorit të Atdheut dhe shoqatat e tyre kanë të drejtë të kërkojnë në organet e pushtetit vendor dhe në Këshillin e Ministrave, marrjen e masave për mirëmbajtjen e varrezave dhe të lapidareve, busteve, pllakave përkujtimore etj., sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 16

Familja e Dëshmorit të Atdheut ruan e trashëgon reliket, dokumentet vetjake, fotografitë, dekoratat, urdhrat etj., që i janë dhënë Dëshmorit të Atdheut, si dhe çdo gjë tjetër që lidhet me të dhe mundet që vullnetarisht t'i dorëzojë ato në muze, ku ruhen e mirëmbahen si objekte të rëndësishme të veçantë.

Neni 17

Familja e Dëshmorit të Atdheut pajiset nga Komisioni me vendimin e tij për njohjen e Statusit të Dëshmorit të Atdheut dhe me simbolin “Familje e Dëshmorit të Atdheut”, të cilin ajo ka të drejtë ta ekspozojë në mjedise të dukshme të banesës së saj në ditët përkujtimore, më 5 Maj, më 28 dhe 29 Nëntor.

Simboli “Familje e Dëshmorit të Atdheut” përbëhet nga një copë e kuqe me thekë, me përmasa 30 x 50 cm, në të cilën është stamposur në ngjyrë ari përmendorja “Nënë Shqipëri” dhe është shkruar anash “Familje e Dëshmorit të Atdheut”.

Neni 18

Organet shtetërore dhe organet e pushtetit vendor organizojnë dhe marrin pjesë në ceremonitë përkujtimore për Dëshmorët e Atdheut, me rastin e 5 Majit, të 28 dhe 29 Nëntorit.

Neni 19

Pjesëtarëve të familjeve të dëshmorëve, kur kanë statusin “I pastrehë” dhe “I papunë”, u sigurohet përparësi për strehim e punësim nga organet e pushtetit vendor.

Neni 20

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për të nxjerrë aktet nënligjore, në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

Neni 21

Dekreti nr.4558, datë 18.10.1969 “Për dëshmorët e Atdheut” dhe dekreti nr.7155, datë

29.1.1998 “Për një ndryshim në dekretin nr.4558, datë 18.10.1996 “Për dëshmorët e Atdheut”, shfuqizohen.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2618, datë 11.5.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr. 8608, datë 27.4.2000

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KISHËS KATOLIKE NË SHQIPËRI PËR NDËRTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E SPITALIT “ZONJA E KËSHILLIT TË MIRË””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Kishës Katolike në Shqipëri për ndërtimin dhe administrimin e spitalit “Zonja e Këshillit të Mirë””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2619, datë 11.5.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

AKTMARRËVESHJE

Në datën njëzet e nëntë të muajit shtator të vitit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre, në prani të SH.T.Dr.Besim Nuri, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe SH.T. Imzot Ivan Dias, Nunci Apostolik i Shqipërisë lidhet akti i mëposhtëm

mes

Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, nëpërmjet Ministrisë së saj të Shëndetësisë, i përfaqësuar sipas qëllimeve të aktit prezent nga SH.T.Dr. Tritan Shehu, Ministër i Shëndetësisë

nga njëra anë
dhe

Kishës Katolike në Shqipëri, e përfaqësuar nga SH.T.Imzot Rrok Mirdita, Arqipeshkëv i Durrësit dhe Tiranës,

nga ana tjetër
parashtrohet

a. se Qeveria Shqiptare, sipas vendimit nr.410 të Këshillit të Ministrave të nxjerrë në datën 6 gusht 1993, i ka dhënë me qira Kishës Katolike në Shqipëri një truall me sipërfaqe 50 000 metër katrorë që ndodhet në Rrugën “Kongresi i Përmetit” në Tiranë (sipas projektit të bashkëngjitur), dhe i ka lejuar kësaj Kisha Katolike përdorimin falas të ndërtesës që ngrihet në të e që është në gjendje të pambuaruar, e cila ishte destinuar për spital urgjence dhe reanimacioni;

b. se kompleksi i paluajtshëm në fjalë, i përbërë nga struktura e papërfunduar, nga trojet përkatës siç u tregua dhe më sipër, i është besuar Kishës Katolike në Shqipëri me qëllim që të realizojë një Spital të Përgjithshëm;

c. se akte të tilla janë kryer për të zbatuar akordin e bërë midis palëve në datën 28.4.1993, falë edhe pjesëmarrjes së Nënë Terezës së Kalkutës, nën kujdesin e madh të së cilës Spitali do të administrohet me emërtimin “Spitali Zoja e Këshillit të Mirë”.

PËRSA U PARASHTRUA bihet dakord për sa vijon:

Neni 1 - Kisha Katolike në Shqipëri pranon koncensionet siç u përcaktuan më sipër. Konstaton që ato janë kryer me qëllim që të lejojnë realizimin e një Spitali të Përgjithshëm me funksionin e qendrës sanitare që i përket gjithë zonës kombëtare.

Qeveria Shqiptare angazhohet të shqyrtojë më vonë mundësinë që të kalojë në pronësi të Kishës Katolike në Shqipëri truallin i cili në hyrje i është dhënë me qira. Një kalim i tillë do të bëhet pa kompensim dhe pa detyrime të karakterit fiskal.

Neni 2 - Kisha Katolike angazhohet në vazhdim të nxisë dhe të mbështesë të gjitha iniciativat e përshtatshme për arritjen e një qëllimi të tillë, përfshirë aty sigurimin e fondeve të destinuar për të përfunduar, mbështetur dhe zhvilluar këtë qendër sanitare.

Neni 3 - Qeveria Shqiptare angazhohet të japë mbështetjen e vet kësaj iniciative, qoftë duke lëshuar autorizimet e nevojshëm sipas rastit, qoftë duke bashkëpunuar direkt, për sa ka kompetenca në fushatat e organizuara për sigurimin e fondeve.

Qeveria Shqiptare angazhohet gjithashtu të autorizojë si mbledhjen e fondeve ashtu edhe përdorimin e shumave, qofshin këto edhe të realizuara ose të ardhura nga jashtë vendit nga iniciativat popullore ose nga veprimet e qeverive të huaja ose organizate internacionale dhe të përjashtojë veprimet që lidhen me shuma të tilla nga detyrimet dhe taksat eventuale që do të mund të rëndonin mbi to.

Neni 4 - Qeveria Shqiptare angazhohet të mbajë të përjashtuar dhe sidoqoftë të përjashtojë Kishën Katolike ose ata që veprojnë në emër të saj nga çdo detyrim ose taksë përkatëse qoftë pasurinë e patundshme qoftë administrimin e entit spitalor, njëlloj si për spitalet shtetërore.

Neni 5 - Qeveria shqiptare angazhohet gjithashtu të furnizojë kompleksin me të gjitha infrastrukturat e nevojshme për funksionimin e tij, midis të cilave specifikohen si shembull ujësjellësit dhe gazsjellësit, rrjeti i energjisë elektrike, rrjeti i kanalizimit dhe gjithçka duhet tjetër për funksionimin e përsosur të vetë spitalit.

Neni 6 - Kisha Katolike do t'ia besojë Kongregacionit të Bijve të Zojës së Papërlyer (i njohur sipas dekretit mbretëror nr.1024 të datës 19 prill 1937, i modifikuar me D.P.R. nr.1538 të datës 6 nëntor 1960, me seli ligjore në Via della Luce 46 Roma) administrimin e Komplexit Spitalor, duke ruajtur të drejtën për t'ia dhënë këtij Kongregacioni edhe pronësinë e tij, pasi të jetë

marrë nga Shteti Shqiptar (shih nenin 1).

Kisha Katolike ruan të drejtën të ngrëjë pranë Spitalit një organizatë për përgatitjen e personelit infermieristik dhe teknik që do të administrohet nga I.D.I. – Instituti Dermopatik i Zojës së Papërlyer, Institut Shtrimi dhe Kurimi me karakter shkencor, i Kongregacioni të Bijve të Zojës së Papërlyer në Romë, Itali.

Palët vënë dukje reciprokisht qëllimin për ta bërë Spitalin në fjalë një qendër didaktike-sanitare me interes kombëtar.

Palët ruajnë të drejtën të shqyrtojnë mundësinë për të lëshuar dëshmi të vlefshme edhe me qëllimin për t'i lejuar qytetarët shqiptarë të punojnë pranë shërbimeve shëndetësore italiane.

Neni 7 - Qeveria Shqiptare dhe Kisha Katolike gjithashtu ruajnë të drejtën të fusin në programin e veprimtarisë formuese dhe të azhurnimit për profesorët dhe funksionarët publikë, që do të zhvillohet në trevjetët e ardhshëm, parashikimin për të zhvilluar pranë Spitalit në fjalë një ose më shumë kurse kualifikimi për mjekët dhe për funksionarët e Administratës Shëndetësore.

Edhe një program i tillë do të administrohet nga I.D.I.- a.

Do të shqyrtohet gjithashtu mundësia për të kryer pranë Spitalit të Përgjithshëm kurse specializimi pasuniversitar për mjekët shqiptarë, mbi bazë titujsh që përputhen me I.D.I.-në dhe që lejojnë marrjen e titujve të vlefshëm edhe për në Itali.

Palët gjithashtu ruajnë të drejtën të shqyrtojnë më tej me vazhdimin e marrëdhënieve, mundësinë e nxitjes së veprimtarive kulturore dhe të dokumentit e të studimit mbi aspektet njerëzore dhe shoqërore të veprimtarisë mjekësore dhe mbi problemet administrative të strukturave shëndetësore.

Kuptohet dhe pranohet nga të dyja palët kontraktuese që Spitali dhe çfarëdo lloj iniciative (nga ato infermieristike dhe akademike) do të drejtohen nga doktrina e Kishës Katolike.

Neni 8 - Palët konstatojnë që I.D.I.-a, e cila ka organizuar me Universitetin Papnor Gregorian në Romë një kurs formimi etik dhe menazherial për mjekët dhe drejtuesit e Shërbimeve shëndetësore, ka treguar gatishmërinë për të bashkëpunuar në programin dhe administrimin e Spitalit të Përgjithshëm Zoja e Këshillit të Mirë e Tiranës, objekt i Marrëveshjes prezente, edhe në kuadrin e një Plani Shëndetësor Kombëtar të ardhshëm, i parapërgatitur nga Ministria e Shëndetësisë Shqiptare, në raste nevojë në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Kërkimeve dhe Institutin Superior të Shëndetësisë Italiane.

Neni 9 - Të dyja palët kontraktuese angazhohen të hartojnë një marrëveshje konkrete për të rregulluar marrëdhëniet që kanë të bëjnë me asistencën spitalore edhe nën profilin ekonomik.

Marrëveshja në fjalë e konkretizuar do të parashikojë detyrimin e Qeverisë Shqiptare për t'i paguar Kishës Katolike në Shqipëri, ose administruesit të Spitalit një shumë të barabartë me koston për vend shtrati që vetë Qeveria Shqiptare përballon në spitalet e veta publike për personelin mjekësor dhe jo mjekësor mbi bazën e pagave në fuqi në Shqipëri.

Palët do të parashikojnë në vazhdim që për çdo pacient të shtruar dhe në lidhje me periudhën faktike të shtrimit, Qeveria Shqiptare, do t'i paguajë administruesit të Spitalit shlyerjen e parave siç u përcaktua më sipër.

Precizohet gjithashtu që qendra shëndetësore në fjalë nuk ka qëllime fitimi dhe do t'i përshtatet legjislacionit shqiptar të tanishëm dhe të ardhshëm përsa i përket kontributeve të popullit për asistencën publike. Gjithashtu mund të pajiset me një shërbim për qytetarët që duan të paguajnë dhe që bëjnë kërkesë për këtë.

Deri në lidhjen e marrëveshjes në fjalë, Qeveria Shqiptare angazhohet të japë një kontribut vjetor për qëllimet e sipërpërmendura, mbi bazën e një akordi që do të rishikohet çdo dy vjet.

Neni 10 - Kisha Katolike vetë ose nëpërmjet atyre që veprojnë në emër të saj do të procedojë t'i parashtrijë Qeverisë një projekt të përfundimit të kompleksit që do të realizohet në kohët dhe mënyrat e gjykuara të përshtatshme nga kjo Kishë Katolike dhe sidoqoftë brenda afatit të dhjetë (10) vjetëve nga nënshkrimi i aktit prezent.

Qeveria shqiptare angazhohet të furnizojë brenda gjashtë muajve që vijojnë të gjitha autorizimet e nevojshme për punimet e ristrukturimit duke e përjashtuar nga çdo detyrim ose taksë, që do të rëndonte kryerjen e punimeve të tilla.

Njëkohësisht me fillimin e punimeve Qeveria Shqiptare angazhohet me vënien në veprim të përdorimit të të gjitha shërbimeve publike dhe furnizimet e të gjitha shërbimeve të përmendura në nenin 5.

Neni 11 - Palët konstatojnë se trualli i ndodhur midis ndërtesës së papërfunduar dhe Rrugës Kongresi i Përmetit i është dhënë nga Bashkia e Tiranës në përdorim privatëve, që po e përdorin si depozitë furgonësh.

Qeveria Shqiptare konstaton që Kisha Katolike në Shqipëri është e interesuar për realizimin e kompleksit spitalor me kusht që trualli i sipërpërmendur të lirohet nga të tretët dhe të vihet në dispozicion të Kishës Katolike.

Akti prezent i nënshtrohet kushtit pezullues e varet nga lirimi dhe dorëzimi në të ardhmen i truallit në fjalë në përdorim të përhershëm të Spitalit të Përgjithshëm, nga ana e Entit Publik që ka të drejta mbi truallin, brenda afatit të nëntëdhjetë (90) ditëve nga nënshkrimi i aktit prezent.

Qeveria Shqiptare angazhohet të shqyrtojë më vonë mundësinë për ta kaluar këtë terren në pronësi të lirë të Kishës Katolike.

Nëse një kusht i tillë nuk verifikohet, kontrata prezente do të humbasë përfundimisht efektshmërinë dhe do të konsiderohet e pavlefshme dhe pa asnjë vlerë juridike, siç do të humbasin efektshmërinë aktet e koncensionit të përmendur në hyrje.

Neni 12 - Kjo marrëveshje do të hartohet në gjuhën shqipe dhe italiane dhe do të firmoset në dy ekzemplarë origjinalë.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Dr. Tritan Shehu
Ministër i Shëndetësisë

Për Kishën Katolike në Shqipëri
Imzot Rrok Mirdita
Arqipeshkvi i Durrësit dhe Tiranës

Dëshmitarë

Dr. Besim Nuri
Zëvendësministër i Shëndetësisë

Arqipeshkvi Ivan Dias
Nunci Apostolik

D E K R E T

Nr. 2624, datë 12.05.2000

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Sajmir Agim Çekani
2. Rudina Xhevdet Schneider (Hamja)
3. Ridjan Luan Schneider
4. Marco Luan Schneider
5. Armando Zef Ndoka
6. Rigel Abdurrahman Pilkati
7. Matilda Tomorr Taraj

8. Arben Kozma Kondi
9. Genc Haxhi Pregja
10. Panajot Vangjel Pasko
11. Bujar Sinan Brahja
12. Anja Bujar Brahja
13. Eva Jorgo Mavrovouniotis (Papa)
14. Violeta Daut Doçi
15. Adriana Sotiraq Seitz (Çomo)
16. Bardhyl Taip Biba
17. Taip Bardhyl Biba
18. Arild Bardhyl Biba
19. Stela Zef Dedushi
20. Pandeli Mihal Pani
21. Agron Mehmet Hoxha
22. Ardjan Bahri Maxhelaku
23. Ray Ardjan Maxhelaku
24. Enkelejda Bujar Maxhelaku (Xhepa)
25. Suzana Gani Sauter (Avdiu)
26. Ali Bajram Balaj
27. Alfred (i) Ibrahim Belishta
28. Gisela Alfred Belishta
29. Pranvera Ibrahim Belishta (Mere)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr. 437, datë 3.5.2000

**PËR ZGJEDHJEN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT
TË SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 5 pika 2 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil” dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Zgjidhen në detyrën e anëtarit të Komisionit të Shërbimit Civil zotërinjtë:

1. Roland Përmeti
2. Gojard Cerga

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr. 437/1, datë 3.5.2000

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT
TË SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 5 pika 2 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil” dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

- I. Zoti Nexhat Gjuzi zgjidhet në detyrën e anëtarit të Komisionit të Shërbimit Civil.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr. 438, datë 3.5.2000

**PËR EMËRIMIN E INSPEKTORES SË PËRGJITHSHME
TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 54 pika 1 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, si dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

- I. Zonja Elsa Bizhga emërohet në detyrën e Inspektorese së Përgjithshme të Bankës së Shqipërisë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.439, datë 3.5.2000

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH-SË

Në mbështetje të neneve 88 dhe 89 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

I. Zoti Shaban Sinani zgjidhet në detyrën e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr. 150, datë 31.3.2000

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TË EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 167, pika 8, të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për shoqëritë tregëtare", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e rregullave për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël, të autorizuar, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Ilir Meta**

R R E G U L L A

PËR ORGANIZIMIN E PROFESIONIT TE EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

KREU I PËR ORGANIZIMIN DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME TË USHTRIMIT TË PROFESIONIT

KAPITULLI 1 ORGANIZIMI I PROFESIONIT

Neni 1

Ekspert Kontabël i Autorizuar është ai profesionist i pavarur i cili, duke qënë i rregjistruar sipas këtyre rregullave, ushtron si profesion kryerjen e misioneve të kontrollit të llogarive të shoqërive tregëtare, ndërmarrjeve apo organizatave të tjera të cilat detyrohen nga ligji për këtë kontroll ose e kërkojnë vetë atë.

Eksperti kontabël i autorizuar kryen edhe misione të tjera dytësore që janë në pajtim me natyrën e profesionit dhe me legjislacionin në fuqi.

Neni 2

Organizmi profesional rreth të cilit grupohen ekspertët kontabël të autorizuar, ashtu sikurse përcaktohet në ligjin " Për Shoqëritë Tregëtare", është Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, i krijuar në bazë të Urdhëresës të Këshillit të Ministrave Nr.1 datë 02.10.1995 dhe regjistruar me Vendimin e Gjykatës të rrethit Tiranë nr. 3573 datë 16.10.1998.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ose shkurt " I.E.K.A. " është person juridik me seli në Tiranë.

-Instituti ka për objekt të sigurojë mirëushtimin e profesionit, mbrojtjen e pavaresisë dhe të nderit të anëtarëve të tij, si dhe mbikqyrjen e formimin profesional të tyre.

Administrimi i Institutit bëhet nëpërmjet organeve të veta, të krijuara a të zgjedhura nga anëtarët e tij, si dhe të organeve të tjera të krijuara pranë institutit, sipas kushteve të përcaktuara në këto rregulla.

Ai mund t'u paraqitë organeve dhe autoriteteve të pushtetit shtetëror çdo kërkesë lidhur me profesionin që përfaqeson si dhe të thirret nga këto organe e autoritete për çështje që kanë të bëjnë me këtë profesion.

Neni 3

Shpenzimet për funksionimin administrativ të institutit përballohen me anë të kuotave të derdhura nga anëtarët e tij.

Funksionet në organet e zgjedhura të institutit nuk janë funksione të punesuari. Megjithatë, me vendim të asamblesë së përgjithshme, anëtarëve të këtyre organeve mund t'u caktohet një shpërblim fiks për pjesëmarrje në veprimtarinë e secilit organ.

Anëtarët e komisioneve dhe të dhomave të apelit për regjistrimin dhe për disiplinën kanë të drejtën e një shpërblimi fiks për ditë të pjesëmarrjes në veprimtarinë e organit përkatës. Ky shpërblim caktohet nga Ministri i Financave, me propozimin e Këshillit të Drejtimit të Institutit.

Anëtarët e të gjitha organeve të institutit kanë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të kryera prej tyre për shërbime në interes të institutit, kundrejt paraqitjes së dokumenteve justifikuese përkatës.

KAPITULLI 2 KUSHTET E PËRGJITHSHME TË USHTRIMIT TË PROFESIONIT

Neni 4

Askush nuk mund të ushtrojë profesionin e ekspertit kontabël të autorizuar pa qenë i regjistruar në listën e institutit, sipas kushteve të përcaktuara në këto rregulla.

Ekspertët kontabël të autorizuar mund ta ushtrojnë profesionin e tyre ose në mënyrë të pavarur (individuale), ose të grupuar në shoqëri, apo si të punësuar tek një ekspert tjetër i pavarur ose tek një shoqëri e ekspertëve kontabël të autorizuar.

Neni 5

Funksionet e ekspertit kontabël të autorizuar janë të papajtueshme me çdo angazhim ose akt të natyrës që dëmton drejtpërdrejtë a tërthorazi pavarësinë ose ndershmërinë e tij.

Përveç ndalimeve, kufizimeve dhe papajtueshmërive të përcaktuara nga ligji nr.7638, date 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" funksionet e ekspertit kontabël të autorizuar janë gjithashtu të papajtueshme me çdo post të punësuari, me çdo akt tregëtie a ndërmjetësimi, me çdo mandat tregtar, madje edhe përfaqësimi gjyqësor në çështjet që interesojnë klientët e tij, me çdo punë kontrolli në një shoqëri, në të cilën ai ka drejtpërdrejtë a tërthorazi interesa personale dhe me çdo veprimtari

tjetër që tenton ta bëjë të varur.

Megjithatë ekspertit kontabël i autorizuar mund të punojë si i punësuar te një anëtar tjetër i institutit, si dhe të japë mësim profesional në shkollë, qoftë edhe si rrogëtar.

Neni 6

Ekspertët kontabël të autorizuar i përmbahen me rreptësi sekretit profesional dhe i nënshtrohen rregullave të deontologjisë që përcaktohen në kapitullin 8 të këtyre rregullave.

Atyre u ndalohet çdo publicitet personal dhe çdo pazarllek me qëllim konkurrence profesionale. Megjithatë ata mund të bëjnë të njohur titujt dhe diplomat e lëshuara nga:

- shteti
- një shkollë shtetërore ose private e njohur nga shteti

Institutit mund të bëjë ose të autorizojë çdo publikim kolektiv që ai e gjykon të dobishëm në interes të profesionit që perfaqëson.

Neni 7

Ushtrimi i paligjshëm i profesionit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar, si dhe përdorimi abuziv i këtij titulli, i emërtimeve të shoqërive të ekspertëve kontabël të autorizuar dhe i çfardo titujve të tjerë që synojnë të krijojnë një ngjashmëri ose një konfuzion me këta tituj a emërtime, përbëjnë një shkelje të ndëshkueshme nga ligjet dhe rregullat në fuqi, pa penguar veprimet ose sanksionet që mund të ndërmerren nga organet e Institutit.

Neni 8

Ekspertët kontabël të autorizuar krijojnë ndërmjet tyre një fond të përbashkët me kuota të caktuara për të financuar formimin profesional në fushën e kontrollit ligjor të llogarive, si dhe për të mbuluar pjesërisht përgjegjësitë personale.

Administrimi i këtij fondi është tërësisht i pavarur, i mëvetshëm dhe kryhet vetëm nga vetë anëtarët e Institutit.

KREU II FUNKSIONIMI I INSTITUTIT

KAPITULLI 3 ORGANET E DREJTIMIT DHE TË KONTROLLIT TË BRËNDSHËM TË INSTITUTIT

Neni 9

Organet e drejtimit dhe të kontrollit të brëndshëm të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar janë :

- asambleja e përgjithshme
- këshilli i drejtimit
- komiteti i kontrollit të brëndshëm

Në rast se gjykohet e nevojshme, mund të krijohen edhe organe rajonale, sipas kushteve të përcaktuara në një rregullim të brëndshëm të vetë Institutit.

SEKSIONI I
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 10

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Institutit. Ajo përbëhet nga të gjithë personat fizikë, anëtarë të Institutit. Çdo anëtar ka vetëm një mandat përfaqësimi në Asamblesë e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme përcakton dhe orienton politikën e përgjithshme të Institutit. Ajo zgjedh dhe revokon anëtarët e këshillit të drejtimit dhe të komitetit të kontrollit të brëndshëm, dëgjon raportet e tyre, vendos për llogaritë e këshillit të drejtimit, miraton rregullimet e brëndshme, organigramen e Institutit dhe çdo rregullim tjetër lidhur me profesionin. Ajo vendos për ndryshimet statutorë të institutit, voton për buxhetin e tij, cakton kuotat e anëtarësisë dhe përgjithësisht vendos për çdo çështje të shkruar në rendin e ditës.

Neni 11

Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brënda gjashtëmuajorit të parë të vitit pasardhës, për të shqyrtuar e vendosur për veprimtarinë vjetore të këshillit të drejtimit dhe të komitetit të kontrollit të brëndshëm. Ajo mbledhet gjithashtu sa herë që është e nevojshme për institutin, kur një gjë e tillë kërkohet nga kryetari i këshillit të drejtimit ose, në mungesë të tij, nga zëvendëskryetari si dhe nga kryetari i komitetit të kontrollit të brëndshëm, nga një e katërta e anëtarëve të Institutit dhe nga përfaqësuesi i mbikqyrës.

Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme caktohet nga autori i thirrjes, i cili duhet t'ua komunikojë gjithë anëtarëve me të gjitha mjetet e mundshme të informimit, të paktën një muaj përpara datës së mbledhjes. Ai tregon gjithashtu vendin e mbledhjes. Në rast urgjence ky afat mund të zbrësë në dhjetë ditë.

Asambleja e Përgjithshme shqyrton vetëm çështjet e shkruara në rendin e ditës. Kryetari i këshillit të drejtimit është i detyruar të shkruajë në rendin e ditës çështjet që i janë paraqitur, të paktën 45 ditë para datës së mbledhjes, nga kryetari i komitetit të kontrollit të brëndshëm, nga një e katërta e anëtarëve dhe nga përfaqësuesi mbikqyrës.

Neni 12

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga një anëtar që nuk bën pjesë në organet e zgjedhura të Institutit, i cili zgjidhet me votim të fshehtë nga anëtarët e pranishëm në seancën e mbajtur për këtë qëllim, mbi bazën e paraqitjes individuale të kandidaturës. Kryetari i mbledhjes zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave. Në rast votash të barabarta, zgjidhet më i moshuari.

Sekretaria e mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme sigurohet nga sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit të institutit.

Neni 13

Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendim vetëm kur në mbledhjen e parë siguron një kuorum që përfaqëson të paktën gjysmën e anëtarëve dhe pas kësaj një numer çfaredo të anëtarëve të pranishëm, me kusht që mbledhja e dytë të bëhet të paktën 15 ditë pas datës së mbledhjes së mëparshme të parashikuar dhe me të njëjtin rend dite.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me shumicë absolute të votave të paraqitura dhe të përcaktuara me votim të fshehtë.

Neni 14

Çdo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme dokumentohet me proces-verbale të hartuara e të nënshkruara bashkërisht nga kryetari dhe sekretari i seancës që u komunikohet gjithë anëtarëve nga sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit të Institutit.

SEKSIONI 2 KËSHILLI I DREJTIMIT TË INSTITUTIT

Neni 15

Këshilli i Drejtimit siguron drejtimin e punës të institutit në pajtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, së cilës edhe i raporton për veprimtarinë e tij.

Këshilli i Drejtimit merr përsipër sidomos këto detyra :

1. Të sigurojë mbrojtjen e profesionit.
2. Të ndjekë respektimin e rregullave të deontologjisë dhe të bëjë plotesimin e tyre në rast se është nevoja.
3. Të marrë masat parashikuese të nevojshme për të mënjeluar çdo akt të natyrës që zhvleron profesionin.
4. Të vendosë për çdo çështje që intereson profesionin e ekspertizës kontabël dhe kontrollin ligjor të llogarive.
5. Të hartojë rregulloren e brëndshme dhe organigramën e institutit si dhe të sigurojë administrimin e institutit e të pasurisë së tij.
6. Të sigurojë funksionimin e rregullt të Institutit dhe bashkërendimin e veprimtarisë së organeve të tij, si dhe kontrollin e cilësisë së punimeve të anëtarëve të Institutit.
7. Të përgatitë e të ndjekë zbatimin e buxhetit të institutit, si dhe të caktojë tabelat e tarifave orare të shperblimit të punëve normale të ekspertëve kontabël të autorizuar.
8. Të përfaqësojë Institutin pranë organeve të pushtetit shtetëror dhe t'u japë këtyre organeve, nëpërmjet autoritetit të mbikqyrjes, mendimet për çështjet e kërkuara.
9. Të sigurojë, së bashku me Ministrinë e Aresimit, formimin profesional të anëtarëve të tij dhe atë të stazhierëve, organizimin dhe zhvillimin e provimeve profesionale, si dhe zbatimin e rregullave për stazhin e stazhierëve.
10. Të proçodojë në kryerjen e çdo studimi që është në kompetencë të tij, të kërkuar nga organet ose autoritetet shtetërore.
11. Të ushtrojë përpara çdo gjykate të gjitha të drejtat e palës civile lidhur me faktet që i sjellin dëm drejtpërdrejtë a tërthorazi interesave kolektive të profesionit.
12. Të arbitrojë dhe të zgjidhë me pajtim çdo konflikt ose mosmarrëveshje të karakterit profesional.

Neni 16

Këshilli i drejtimit përbëhet nga 6 deri ne 8 anëtarë dhe strukturohet si vijon :

- kryetari;
- zëvendëskryetari
- sekretar i përgjithshëm
- financieri
- drejtues teknik të fushave të profesionit.

Anëtarët e këshillit të drejtimit zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një afat prej tre vjetësh. Ata mund të rizgjidhen, por jo më shumë se dy herë radhazi.

Zgjedhjet e anëtarëve të këshillit të drejtimit bëhen me votim të fshehtë, në bazë të paraqitjes individuale të kandidaturës. Kandidati që fiton numrin më të madh të votave, caktohet zyrtarisht

kryetar i këshillit të drejtimit. Në rast mospranimi nga ana e tij, kryetar caktohet kandidati vijues për nga numri i votave të fituara e kështu me radhë. Në rast votash të barabarta, përparësi i jepet kandidatit më të moshuar. Funkcionet e tjera të drejtimit sipas paragrafit të parë caktohen nga kryetari i këshillit të drejtimit, në marreveshje me anëtarët e tjerë të zgjedhur.

Neni 17

Këshilli i drejtimit mbledhet sa herë që është e nevojshme, por jo më rrallë se një herë në tre muaj.

Ai mund të marrë vendime kur janë të pranishëm, jo me pak se dy të tretat e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë absolute votash të anëtarëve të këshillit, nga të cilat njëra duhet të jetë e kryetarit ose, në mungesë të tij, e zëvendëskryetarit. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit ose, në mungesë të tij, e zëvendëskryetarit janë përcaktuese.

Neni 18

Në rast revokimi, vdekjeje ose pengimi të një anëtari të këshillit të drejtimit, ky këshill mund të kooptojë deri në kryerjen e zgjedhjeve të ardhshme, një anëtar tjetër ndër kandidatet jo të zgjedhur në zgjedhjet e fundit, i cili ka fituar numrin më të madh të votave. Megjithkëtë numri i anëtarëve të kooptuar nuk duhet të jetë më shumë se dy. Në rast se ky numër tejkalohet, Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet menjëherë për të caktuar anëtarët që mungojnë, duke përfshirë edhe anëtarët e kooptuar. Anëtarët e rinj të zgjedhur përfundojnë mandatin e anëtarëve të mëparshëm.

SEKSIONI 3 KOMITETI I KONTROLLIT TË BRËNDSHËM

Neni 19

Komiteti i kontrollit të brëndshëm ka për detyrë të verifikojë veprimtarinë financiare të institutit, pajtueshmërinë e veprimeve të regjistruara në llogari me buxhetin, si dhe rregullaritetin e sinqeritetin e llogarive vjetore të këshillit të drejtimit.

Për verifikimet e kryera dhe përfundimet e nxjerra prej tyre, komiteti i kontrollit të brëndshëm i paraqet një raport Asamblesë së Përgjithshme të Institutit.

Anëtarët e komitetit të kontrollit të brëndshëm nënshkruajnë bashkërisht raportin. Në rast mosmarreveshjeje, secili prej tyre paraqet vecas mendimet dhe vleresimet në asamblenë e përgjithshme, e cila vendos përfundimisht.

Neni 20

Komiteti i kontrollit të brëndshëm përbëhet të paktën nga dy anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme për tre vjet. Ata mund të rizgjidhen, por jo më shumë se një herë.

Zgjedhja e anëtarëve të kontrollit të brëndshëm bëhet me votim të fshehtë dhe me paraqitje individuale të kandidaturës. Kryetar i komitetit të kontrollit të brëndshëm caktohet ai që ka fituar numrin më të madh të votave. Në rast votash të barabarta, kryetar caktohet më i moshuari.

KAPITULLI 4 ORGANET E REGJISTRIMIT DHE TË DISIPLINËS

Neni 21

Organet e regjistrimit dhe të disiplinës që krijohen pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të

Autorizuar janë:

- komisioni i regjistrimit;
- dhoma e apelit për regjistrimin;
- komisioni i disiplinës;
- dhoma e apelit për disiplinën;

Anëtarët e këtyre organeve caktohen për tre vjet, sipas kushteve të treguara në nenet 22-28 të këtyre rregullave. Ata mund të ricaktohen.

Për çdo anëtar titullar caktohet një anëtar plotësues sipas të njëjtave kushte. Anëtarët plotësues kanë për detyrë kryesore të kryejnë shqyrtimet paraprake të çështjeve, kërkimet e nevojshme lidhur me to dhe të përgatitin raportet përkatëse. Në rast mungese ose pengimi të anëtarëve titullarë, anëtarët plotësues i zëvendësojnë ata në të gjitha funksionet e tyre.

Në ushtrimin e funksioneve të tyre anëtarët e organeve të regjistrimit dhe të disiplinës i përmbahen ruajtjes të sekretit profesional.

SEKSIONI I KOMISIONI I REGJISTRIMIT

Neni 22

Komisioni i regjistrimit ka si objekt kryesor regjistrimin dhe çrregjistrimin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar nga lista e institutit, si dhe hartimin e revizionimin vjetor të kësaj liste.

Komisioni i regjistrimit përbëhet nga pesë veta:

- një kryetar, jurist i caktuar nga Ministri i Tregtisë;
- një anëtar i caktuar nga Ministri i Financave;
- një anëtar i caktuar nga Ministri i Arsimit;
- një anëtar, pedagog në shkollën e lartë në fushën e së drejtës ose të ekonomisë, i caktuar nga Ministri i Arsimit;
- një anëtar, ekspert kontabël i autorizuar, i caktuar nga Keshilli i Drejtimit i Institutit.

Neni 23

Komisioni i regjistrimit mbledhet të paktën një herë në vit për të përditësuar listën e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe aq herë sa është e nevojshme, sipas kërkesës të kryetarit të këshillit të drejtimit të institutit.

Komisioni i regjistrimit merr vendim kur në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij, ndër të cilët dy anëtarë titullarë. Vendimet merren me shumicë absolute votash. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit të komisionit është përcaktuese.

Çdo vendim i komisionit të regjistrimit i njoftohet këshillit të drejtimit të institutit dhe të interesuarit.

Vendimet për hedhjen poshtë të kërkesave për t'u regjistruar në listën e institutit duhet të jenë të motivuara.

Vendimet e komisionit të regjistrimit janë të apelueshme pranë dhomës së apelit për regjistrimin.

SEKSIONI 2 DHOMA E APELIT PËR REGJISTRIMIN

Neni 24

Dhoma e apelit për regjistrimin shqyrton ankimet ndaj vendimeve të komisionit të regjistrimit.

Ajo përbëhet nga shtatë anëtarë:

- një kryetar, jurist i caktuar nga Ministri i Drejtësisë ndër punonjësit e kësaj ministrie;
- një përfaqësues i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit ose i një organi analog me të ;
- një përfaqësues i Ministrisë së Financave;
- një përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë;
- një dekan i Fakultetit të Drejtësisë ose i Fakultetit të Ekonomisë, i caktuar nga Ministri i Arsimit;
- një anëtar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, i caktuar nga kryetari i këtij këshilli;
- një anëtar i Këshillit të Drejtimit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, i caktuar nga kryetari i këtij këshilli.

Anëtarët e dhomës së apelit për regjistrimin nuk mund të jenë anëtarë të komisionit të regjistrimit.

Neni 25

Dhoma e apelit për regjistrimin mblidhet dhe procedon sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 41 të këtyre rregullave.

SEKSIONI 3 KOMISIONI I DISIPLINËS

Neni 26

- Komisioni i disiplinës ka si objekt kryesor :
- të shqyrtojë çështjet disiplinore dhe shkeljet e rregullave të deontologjisë nga anëtarët e institutit;
 - të mbikqyrë mbrojtjen e interesave të të tretëve dhe të shtetit nga shkeljet e mësipërme.

Neni 27

Komisioni i disiplinës përbëhet nga pesë anëtarë:

- një kryetar, jurist i caktuar nga Ministri i Tregtisë;
- një përfaqësues i Ministrisë së Financave;
- një profesionist i kualifikuar në fushën e drejtimit të ndërmarrjeve, i caktuar nga kryetari i Dhomës së Tregtisë;
- dy përfaqësues të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, të caktuar nga këshilli i drejtimit.

Neni 28

Komisioni i disiplinës merr në shqyrtim ankesat e ngritura ndaj ekspertëve kontabël të autorizuar nga çdo person i interesuar dhe duhet të vendosë brënda një afati prej dy muajsh nga data e marrjes së ankesës.

Komisioni i disiplinës merr vendim kur janë të pranishëm gjithë anëtarët e tij, ndër të cilët të paktën dy anëtarë titullarë.

Vendimet e komisionit merren me shumicë absolute votash. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit është përcaktuese. Vendimet duhet të jenë në çdo rast të motivuara.

Vendimet e komisionit të disiplinës mund të apelojnë pranë dhomës së apelit për disiplinën.

SEKSIONI 4
DHOMA E APELIT PËR DISIPLINËN

Neni 29

Dhoma e apelit për disiplinën përbëhet nga shtatë anëtarë:

- një kryetar, jurist, i caktuar nga Ministri i Financave ndër punonjësit e kësaj ministrie;
- një perfaqësues nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.
- një anëtar i caktuar nga Kryetari i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, ose i një organi tjetër analog;
- një anëtar i caktuar nga Ministri i Financave;
- një anëtar i caktuar nga Kryetari i Dhomës së Tregtisë;
- një anëtar i caktuar nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit;
- një anëtar, ekspert kontabël i autorizuar, i caktuar nga këshilli i drejtimit të institutit.

Anëtarët e dhomës së apelit për disiplinën nuk mund të bëjnë pjesë në komisionin e disiplinës.

Neni 30

Dhoma e apelit për disiplinën mbledhet sa herë që është e nevojshme për të shqyrtuar e marrë vendim për çështjet që i janë paraqitur. Ajo duhet të vendosë brenda dy muajve nga data e marrjes së kërkesës për apelim.

KAPITULLI 3
ORGANI I MBIKQYRJES

Neni 31

Mbikqyrja shtetërore mbi Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ushtrohet nga Ministri i Financave, i cili për këtë qëllim cakton një përfaqësues titullar dhe dy përfaqësues plotësues pranë këshillit të drejtimit të institutit.

Përfaqësuesi i caktuar mban titullin “Përfaqësuesi mbikqyrës” dhe mund të delegojë, nën përgjegjësinë e tij dhe me pëlqimin paraprak të Ministrit të Financave, të gjitha ose një pjesë të funksioneve të tij përfaqësuesve plotësues.

Neni 32

Përfaqësuesi mbikqyrës ka si detyra kryesore :

- të mbrojë interesat e shtetit dhe ato të të tretëve që kanë marrdhënie me anëtarët e institutit;
- të asistojë personalisht ose me anë të përfaqësuesve plotësues në mbledhjet e këshillit të drejtimit dhe në ato të organeve të tjera të vetë institutit; ai merr çdo informacion paraprak për këto mbledhje, si dhe dokumentet përkatës;
- të bëjë rekurse kundër vendimeve të institutit dhe të organeve të tij;
- të kryejë të gjitha kontrollet e nevojshme për mbarëvajtjen e institutit.

Neni 33

Vendimet e organeve drejtuese të institutit, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me emerimet dhe buxhetin, janë të zbatueshme vetëm pas miratimit paraprak të “Përfaqësuesit

mbikqyrës”. Ky miratim duhet të jepet brënda një muaji nga data e marrjes së vendimit të dhënë. Në mbarim të këtij afati heshtja e përfaqësuesit mbikqyrës do të thotë miratim. Kjo duhet të tregohet në tekstin e vendimit. Refuzimi i miratimit duhet të jetë i motivuar.

Refuzimi i përfaqësuesit mbikqyrës mund të bëjë objekt të një rekursi nga ana e këshillit të drejtimit të institutit të Ministri i Financave, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e refuzimit.

KAPITULLI 6 MBI REGJISTRIMIN NË LISTËN E EKSPERTËVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

SEKSIONI I PROCEDURAT DHE KUSHTET E REGJISTRIMIT

Neni 34

Kërkesa për t’u regjistruar në listën e ekspertëve kontabël të autorizuar i adresohet komisionit të regjistrimit nëpërmjet sekretariatit të përgjithshëm të këshillit të drejtimit të institutit. Ajo dorezohet dorazi kundrejt marrjes së nënshkrimit ose dërgohet me letër rekomande me kthim përgjigje për marrje në dorezim.

Kërkesat e paraqitura regjistrohen kronologjikisht në një libër të posaçem të numërtuar, nënshkruar e vulosur nga “Përfaqësuesi mbikqyrës”. Në libër shënohen emri, mbiemri dhe adresa e kandidatit ose, në rastin e një shoqërie, emërtimi dhe selia e saj, si dhe data e marrjes së kërkesës dhe indentifikimi i dokumenteve që i janë bashkëlidhur asaj.

Kur dosja është e plotësuar, ajo i dërgohet kryetarit të komisionit të regjistrimit brënda dhjetë ditëve, i cili cakton një raportues ndër anëtarët plotësues të komisionit, për të mbledhur të gjitha të dhënat e nevojshme dhe për t’i paraqitur komisionit të regjistrimit një raport përshkrues brënda një muaji nga data e caktimit të tij.

Neni 35

Për t’u regjistruar në listën e ekspertëve kontabël të autorizuar kandidati duhet të plotësojë këto kushte:

1. Të jetë shtetas shqiptar prej më shume se pesë vjetesh.
2. Të gëzojë të drejtat civile.
3. Të mos ketë pësuar asnjë dënim penal ose plotësues të natyrës që çënon ndershmërinë e tij.
4. Të jetë i moshës mbi 25 vjeç.
5. Të jetë titullar i diplomës së kërkuar, niveli i së cilës të jetë i barasvlershëm të paktën me diplomën universitare të shkencave ekonomike.
6. Të ketë një stazh profesional të paktën prej tre vjetësh, i gjykuar i mjaftueshëm nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe Ministria e Arsimit.
7. Të ketë kaluar me sukses provimin e aftësive profesionale, të organizuar bashkërisht nga Ministria e Arsimit dhe Instituti.
8. Të paraqitë garancitë e moralitetit dhe të ndershmërisë të gjykuara të mjaftueshme nga komisioni i regjistrimit.

Kandidatët që kanë diplomë të ekspertizës kontabël, përjashtohen nga kushtet e pikave 5, 6 dhe 7 të këtij neni.

Deri në Dhjetor 2000, mund të përjashtohen nga kushti për stazhin profesional të parashikuar nga pika 6 me siper, personat të cilët justifikojnë se:

- Gjatë të paktën dy vjeteve kanë qenë të angazhuar në kontrollin e llogarive në kuadrin e zgjidhjeve tranzitore të bëra me Vendime të këshillit të Ministrave ose, kanë qenë të

punësuar, asistente apo bashkëpunëtorë tek shoqeri audite të huaja që operojnë në Shqipëri apo tek ekspertë kontabël të autorizuar vëndas.

- Gjatë 3 vjetëve, duke filluar nga 1 janari 1994, kanë ushtruar një veprimtari profesionale që u ka mundësuar të fitojnë një përvojë të mjaftueshme në fushat financiare, kontabël dhe të kontrollit të llogarive.

Neni 36

Në listën e institutit mund të rregjistrohen persona fizike të huaj të njohur si Ekspert Kontabël të Autorizuar apo me një titull ekuivalent nga një organizëm profesional ose autoritet publik i shtetit të cilit i përkasin. Në këtë rast vleresimi i aftesisë profesionale do të kufizohet në një provim të së drejtës shqipëtare për aq sa i intereson profesionit.

Instituti bën njohjen me rregjistrim të shoqërive audite të huaja, të cilat, për një kohë të caktuar ose të pakufizuar, me ose pa zyra përfaqësimi në Shqipëri, kryejnë kontrollin ligjor të llogarive të bankave apo të shoqërive të tjera tregëtare. Shoqëritë audite të huaja apo zyrat përfaqësuese të tyre në Shqipëri rregjistrohen në një listë të veçante të Institutit.

Neni 37

Shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar rregjistrohen vetëm nëse janë shoqëri profesionale dhe përmbushin kërkesat e parashikuara nga ligji nr.7953, datë 21.6.1995.” Per disa ndryshime ne ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 “Per Shoqerite Tregëtare””.

Çdo kërkesë për regjistrimin e një shoqërie të ekspertëve kontabël të autorizuar paraqitet kolektivisht nga ortakët e saj. Kërkesës i bashkëlidhen:

1. Një kopje e statutit
2. Një kërkesë të çdo ortaku që kërkon regjistrimin e shoqërisë në listën e institutit.
3. Një vërtetim të gjykatës të regjistrimit për regjistrimin e shoqërisë.
4. Një listë të drejtuesve dhe të administratorëve të shoqërisë me adresat e tyre.

Regjistrimi i shoqërive të ekspertëve kontabël të autorizuar mund të refuzohet vetëm kur statuti nuk është në pajtim me dispozitat ligjore ose rregulluese në fuqi, ose kur dokumentet e parashikuara më sipër nuk i janë paraqitur komisionit të regjistrimit.

Ankimet kundër vendimeve të komisionit të regjistrimit bëhen sipas të njëjtave kushte si për ekspertët kontabël persona fizikë.

Neni 38

Komisioni i regjistrimit shqyrton dosjen e paraqitur nga raportuesi dhe vlereson nëse kandidati i plotëson kërkesat e parashikuara për regjistrim. Po të jetë e nevojshme, ai mund të kërkojë edhe të dhëna të tjera plotësuese.

Komisioni i regjistrimit mund të thërrasë kandidatin për ta dëgjuar. Ky i fundit mund të asistohet nga një këshilltar i zgjedhur nga vete ai.

Komisioni i regjistrimit duhet të vendosë e shumta brënda muajit nga data e dorezimit të raportit nga raportuesi. Në mbarim të këtij afati, regjistrimi i kandidatit në listën e institutit quhet i bërë.

Nëse në datën e pranimit kandidati gjendet në një nga rastet e papajtueshmërive të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, ai nuk mund të ushtrojë profesionin e tij, nëqoftëse nuk justifikon pranë komisionit dhënien fund të papajtueshmërisë, i cili informon për këtë këshillin e drejtimit të institutit. Në rast të kundërt, pas një afati prej gjashtë muajsh, kandidati quhet se është tërhequr zyrtarisht dhe komisioni me kërkesë të kryetarit të këshillit të drejtimit, kryen çrregjistrimin nga lista e institutit.

Neni 39

Brenda 15 ditëve nga data e marrjes së vendimit nga komisioni i regjistrimit, sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit njofton kryetarin e këshillit të drejtimit dhe të interesuarin.

Apelimi i vendimeve të komisionit të regjistrimit bëhet brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Ai i adresohet kryetarit të dhomës së apelit për regjistrim nëpërmjet sekretariatit të përgjithshëm të këshillit të drejtimit:

- nga kandidati kundër vendimit të komisionit, në rastin e refuzimit të kërkesës për regjistrim;

- nga kryetari i këshillit të drejtimit kundër çdo vendimi të regjistrimit të një kandidati në listë që nuk përmbush plotësisht kërkesat ligjore a morale.

Neni 40

Brenda tetë ditëve nga data e marrjes së kërkesës për apelim, sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit njofton personat përkatës dhe kryetarin e komisionit të regjistrimit. Njoftimi bëhet me çdo mjet komunikimi, por me kthim përgjigjeje të shkruar për marrjen e tij.

Neni 41

Dhoma e apelit për regjistrimin mbledhet në seancë plenare për të shqyrtuar kërkesën për apelim në një afat jo më shumë se dy muaj nga data e njoftimit të kërkesës nga sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit.

Vendimet e dhomës së apelit për regjistrimin mund të merren kur janë të pranishëm gjithë anëtarët titullarë, ose, në rast të pengimit të tyre, anëtarët plotësues. Vendimet merren me shumicë votash. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit të dhomës është përcaktuese.

Vendimet e dhomës së apelit për regjistrim janë të formës së prerë.

Sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit bën njoftimin e vendimit, për personat e interesuar, brenda tetë ditëve nga data e marrjes së tij. Njoftimi bëhet me leter rekomande e kthim përgjigjeje, ose me çdo mënyrë tjetër komunikimi ekuivalent.

SEKSIONI 2

BETIMI

Neni 42

Para se të hyjë në funksion çdo ekspert kontabël i autorizuar duhet të bëjë betimin përpara komisionit të disiplinës.

Betimi bëhet me shkrim sipas formulës “Betohe se do të ushroj profesionin tim me ndërgjegje dhe bindje, se do të respektoj dhe do të kërkoj të respektohen ligjet në të gjitha punimet e mija.

SEKSIONI 3

HARTIMI I LISTËS SË INSTITUTIT

Neni 43

Lista e anëtarëve të institutit, persona fizike ose shoqëri, hartohet nga komisioni i regjistrimit dhe i dërgohet këshillit të drejtimit.

Ajo përmban seksionet që vijojnë:

1. Seksioni i ekspertëve kontabël të autorizuar që ushtrjnë profesionin e tyre në mënyrë

individuale.

2. Seksioni i ekspertëve kontabël të autorizuar që ushtrojnë profesionin e tyre si të punësuar te një ekspert tjetër, ose te një shoqëri e ekspertëve kontabël të autorizuar.

3. Seksioni i shoqërive të ekspertëve kontabël të autorizuar, të njohur nga instituti.

Lista e anëtarëve të institutit hartohet sipas rretheve, ku ekspertët kontabël të autorizuar ose shoqëritë e tyre kane selinë, pavarësisht nga fakti që ata mund ta ushtrojnë profesionin e tyre në të gjitha rrethet e vendit.

Neni 44

Çdo vit komisioni i regjistrimit kryen revizionimin vjetor të listes së personave të regjistruar dhe përgatit listën e datës 1 Janar.

Me rastin e revizionimit vjetor komisioni hedh në listë vendimet e regjistrimit të marra gjatë vitit, fshin emrat e atyre që kane vdekur, që kane dhënë dorëheqjen, që kanë qënë objekt i një mase për fshirjen nga lista, ose që nuk përmbushin kushtet ligjore a rregulluese për t'u mbajtur në listë.

Neni 45

Lista e hartuar çdo vit nga komisioni shpallet përpara datës 31 Janar të çdo viti në ambjentet e selise se Këshillit drejtues të institutit të caktuar për këtë qëllim.

Në të njëjtën afat sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit u dërgon kopje të listes:

- prokurit të çdo rrethi;
- gjykatave të shkallës së parë të çdo rrethi;
- gjykatës së apelit;
- Bashkive, që i shpallin në lokalet e selisë së tyre, si dhe i publikojnë në një gazetë lokale të njoftimeve zyrtare.

SEKSIONI 4 NDËRPRERJA E VEPRIMTARISË DHE RIREGJISTRIMI

Neni 46

Çdo anëtar i institutit mund të kërkojë të tërhiqet përkohësisht nga instituti. Kërkesa i adresohet komisionit të regjistrimit dhe dorezohet ose i dërgohet sekretariatit të përgjithshëm të këshillit të drejtimit. Ajo duhet të jetë e motivuar dhe të tregojë sidomos veprimtarinë e re që do të ndermarrë i interesuari, si dhe datën, në të cilën ai kërkon të tërhiqet nga instituti.

Këshilli i drejtimit duhet t'ia përcjellë kërkesën komisionit të regjistrimit brenda tetë ditëve. Ky i fundit vendos me procedurë normale brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës.

I interesuari ka të drejtë të nisë veprimtarinë e re përpara marrjes së vendimit nga komisioni i regjistrimit, me kusht që të informojë për këtë me shkrim kryetarin e këshillit të drejtimit të paktën dhjetë ditë me parë, të jetë në rregull me derdhjen e kuotave të tij dhe të ketë pushuar veprimtarinë e ekspertit kontabël të autorizuar.

Komisioni i regjistrimit e quan të drejtë kërkesën dhe e heq të interesuarin nga lista e institutit, nëqoftëse çmon se veprimtaria e tij e re nuk është e natyrës që u sjell dëm interesave morale të institutit.

Nga data e njoftimit të vendimit që shpall heqjen nga lista, i interesuari nuk është më anëtar i institutit. Ai nuk mund të ushtrojë në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij profesionin e ekspertit kontabël të autorizuar dhe as të përdorë këtë titull.

Heqja nga lista e institutit e kërkuar nga vetë anëtari nuk ka efekt të shuajë veprimet disiplinore për shkelje të lejuar më parë.

Neni 47

Anëtari i tërhequr nga instituti mund të kërkojë reregjistrimin e tij. Në këtë rast kushtet e aftësisë profesionale çmohen në pajtim me dispozitat në fuqi në ditën e regjistrimit të parë, ose në datën e tërheqjes së përkohëshme.

KAPITULLI 7 PROVIMI AFTËSISË PROFESIONALE

Neni 48

Për t'u paraqitur në provimin e aftësisë profesionale, kandidatët duhet të plotësojnë paraprakisht të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 35 të ketyre rregullave.

Kërkesat e kandidaturave për provimin e aftësisë profesionale i adresohen këshillit të drejtimit të institutit me anë të dorezimit të drejtpërdrejtë në sekretariatit e përgjithshëm, ose të dërgimit me letër rekomande e kthim përgjigjeje për marrjen në dorezim.

Neni 49

Provimi i aftësisë profesionale përmban të paktën pesë prova të detyrueshme dhe me shkrim që kanë të bëjnë me këto disiplina:

1. Kontabiliteti, analiza e llogarive dhe revizioni kontabël.
2. E drejta civile, tregtare e shoqërive, penale dhe e punës në masën që këto interesojnë kontrollin ligjor të llogarive.
3. Normat kontabël, juridikë dhe profesionale.
4. Organizimi, administrimi dhe kontrolli i brëndshëm i ndërmarrjeve, duke përfshirë sistemet e informacionit dhe të informatikës.
5. Tatimet.

Çdo njëra nga këto prova vlerësohet me një notë nga 0 deri 20. Mesatarja e përgjithshme e domosdoshme për t'u kualifikuar është nga 10 deri në 20. Megjithatë çdo notë e tri provave të para më e vogël se 10 është eliminuese.

Kohëzgjatja minimum e çdo prove është katër orë.

Neni 50

Juria e provimit përbëhet nga pesë anëtarë të caktuar me vendim të Ministrit të Arsimit:

- | | |
|--|---------|
| - një përfaqësues i Ministrit të Arsimit | kryetar |
| - një përfaqësues i Ministrit të Financave | anëtar |
| - kryetari i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit | anëtar |
| - një përfaqësues i Institutit të Eksperteve Kontabël | anëtar |
| - një profesor i arsimit të lartë në fushën e së drejtës civile e penale | anëtar |

KAPITULLI 8 RREGULLAT E DENTOLOGJISE

Neni 51

Sigurimi i ruajtjes së pavarësisë dhe të nderit të institutit dhe dhënia e autoritetit të duhur veprimtarisë së anëtarëve të tij kërkon nga këta të fundit

- kompetencë e ndërgjegje profesionale;
- bindje dhe dinjitet;
- pavarësi morale dhe materiale.

Çdo anëtar i institutit duhet të bëjë përpjekje për zhvillimin e cilësive të mësipërme dhe zbatimin e tyre në çdo rast, duke vepruar në pajtim me traditat e vendit, me etikën profesionale dhe me dispozitat ligjore e nënligjore.

Anëtari i institutit duhet të përpiqet të zgjidhë me pajtim çdo mosmarrëveshje me kolegët e tij, dhe, nëse nuk e arrin këtë, ai mund të verë në dijeni kryetarin e këshillit të drejtimit, i cili do të luajë rolin e arbitrit për një rregullim pajtues.

Neni 52

Një anëtar i institutit mund të përdorë në ushtrimin e profesionit deri në pesë punonjës të punësuar të caktuar për kontrollin ligjor të llogarive. Emrat e të punësuarve duhet t'i komunikohen paraprakisht dhe me shkrim kryetarit të këshillit të drejtimit të institutit. Stazhierët dhe të punësuarit për punë joprofesionale nuk përfshihen në numrin e mësipërm.

Në rastin e shoqërive të ekspertëve kontabël të autorizuar, numri i të punësuarve për punë profesionale është në varësi të numrit të ekspertëve kontabël të autorizuar, ortakë të shoqërisë në kufijtë e treguar më sipër.

Neni 53

Një anëtar i institutit nuk mund të bashkëpunojë me një ekspert kontabël të autorizuar, ndaj të cilit është marrë një masë disiplinore që përmban ndalimin e ushtrimit të profesionit ose pezullimin e përkohshëm gjatë kohës së vuajtjes së dënimit.

Neni 54

Veprimtaria e anëtarëve të institutit ose e shoqërive të njohura prej tij nuk mund t'i kushtohet në pjesën më të madhe një ndërmarrjeje të vetme, një grupi financiar ose vetëm një bashkësie interesash. Ky prag quhet i arritur kur shpërblimi që merret prej ekspertit ose shoqërisë se eksperteve, tejkalon 50 për qind të të ardhurave të përgjithshme vjetore.

Anëtari i institutit nuk mund të marrë pjesë në drejtim apo administrimin e më shumë se një shoqërie të ekspertëve kontabël të autorizuar të njohur nga instituti dhe që ushtron veprimtarinë e saj në Shqipëri.

Neni 55

Në kohën e emërimit dhe gjatë mandatit të ekspertit kontabël të autorizuar në një shoqëri, anëtari i institutit duhet të sigurohet që është i pavarur nga shoqëria dhe nga drejtuesit e saj dhe që asgjë nuk i sjell dëm pavarësisë dhe ndershmërisë së tij. Nëse ai çmon se është në një gjëndje që cënon pavarësinë dhe ndershmërinë e tij, duhet që t'i japë fund kësaj gjëndjeje ose duhet të japë dorëheqjen.

Neni 56

Përpara se të marrë në ngarkim një mision të ri, çdo ekspert kontabël i autorizuar duhet të informojë për këtë kryetarin e këshillit të drejtimit të institutit. Njoftimi bëhet me letër rekomande me kthim përgjigjeje. Në njoftim tregohet natyra e misionit, kushtet dhe normat e punës, kohëzgjatja e misionit, honoraret dhe mënyra e llogaritjes së tyre, si dhe emri i anëtarit të institutit që ka qenë më parë, kur ekziston një i tillë.

Mosrespektimi i këtij detyrimi sjell pezullimin e përkohshëm nga ushtrimi i profesionit. Pezullimi vendoset nga komisioni i disiplinës, duke u mbështetur në ankimin e paraqitur nga kryetari i këshillit të drejtimit të institutit.

Neni 57

Çdo ndryshim në veprimtarinë e anëtarëve të institutit duhet t'i bëhet i ditur këshillit të drejtimit brenda dhjetë ditëve, përndryshe anëtari i interesuar rrezikon të ndëshkohet nga ana disiplinore.

Neni 58

Çdo anëtar i institutit duhet të krijojë për cdo çështje që ka në ngarkim një dosje të plotë që përmban identitetin e shoqërisë përkatëse, të drejtuesve të saj, si dhe të gjitha dokumentet e marra ose të përgatitura prej tij me rastin e ushtrimit të funksioneve të tij. Ai duhet të mbajë regjistrat profesionalë, në të cilët shënon punimet e ndryshme të kryera nga ai vetë ose nga të punësuarit e tij. Regjistrat profesionalë mbahen sipas shoqërive që ai kontrollon dhe përmbajnë të paktën datën, kohëzgjatjen dhe natyrën e punimeve të kryera, identitetin e bashkëpunëtorëve dhe të dhëna të tjera që mundësojnë kontrollin e mëvonshëm të punimeve të kryera prej tij. Anëtari i institutit duhet të paraqesë çdo vit regjistrat e tij për t'u parë nga kryetari i këshillit të drejtimit.

Mosmbajtja e dosjeve dhe e regjistrave profesionalë ndëshkohet me ndalimin e ushtrimit të profesionit. Kjo masë merret nga këshilli i drejtimit me kërkesë të çdo personi të interesuar. Në rast përsëritjeje masa për ndalimin e ushtrimit të profesionit vendoset nga komisioni i disiplinës, në bazë të ankesës të çdo personi të interesuar.

Neni 59

Anëtari i institutit, i kërkuar nga një klient për të zëvendësuar një ekspert kontabël të autorizuar tjetër, mund ta pranojë misionin vetëm pasi të jetë informuar me shkrim nga ky i fundit dhe pasi të jetë siguruar që kërkesa nuk rrjedh nga dëshira e klientit për të shmangur efektet e kryerjes rigorozë të detyrave profesionale nga ana e paraardhësit, siç janë këmbëngulja për të nxjerrë në shesh të vërtetën, për të respektuar veten dhe për të kërkuar respektimin e ligjeve në punët e tij.

Ai duhet të mënjanojë çdo kritikë personale ndaj paraardhësit.

Para se të hyjë në funksion, ai duhet të ketë marrë një dokument që përligj pagimin e honorareve paraardhësit të tij, kur kjo rezulton nga një marrëveshje qartësisht e përcaktuar, ose kur i përgjigjet tabelës së hartuar nga instituti për punimet e kryera dhe kur zbatimi i punimeve nga paraardhësi nuk është kundërshtuar nga klienti. Nëqoftëse nuk është kështu, ai mund të fillojë funksionin e tij, pasi t'ia ketë referuar çështjen kryetarit të këshillit të drejtimit dhe të ketë shfaqur rezervat e nevojshme pranë klientit të tij.

Neni 60

Anëtarëve të institutit u ndalohet të kërkojnë klientelë me anë të zbatimit të tarifave të ulëta, të akordimit klientëve ose të tretëve zbritje nga honoraret, të kryerjes së veprimeve me karakter pazarllëku në çfarëdo forme që të jetë, qoftë personalisht, qoftë nëpërmjet personave të tjerë, për llogari të tyre ose për llogari të të tretëve. Atyre u ndalohet gjithashtu të bëjnë konferenca që kanë karakter publikimi.

Neni 61

Anëtarët e institutit janë të pavarur nga administratat shtetërore, por duhet të kenë me to

raporte mirësjelljeje dhe të veprojnë me ndershmëri të plotë në marrëdhëniet profesionale me përfaqësuesit e këtyre administratave.

Neni 62

Anëtarët e institutit janë të detyruar të paguajnë një kuotë profesionale të caktuar nga asambleja e përgjithshme, e cila përcakton gjithashtu datën kufi të pagimit. Regjistrimi në listën e hartuar sipas nenit 45 përmban detyrimin për pagimin e kuotës për të gjithë vitin paraardhës.

Neni 63

Anëtarët e institutit janë përgjegjës për aktet e tyre profesionale. Përgjegjësia e shoqërive të ekspertëve kontabël të njohura nga instituti nuk zëvendëson përgjegjësinë personale të çdo eksperti kontabël ndaj institutit, për shkak të punimeve që ai kryen për llogari të shoqërive dhe që duhet të dalë nga nënshkrimi i tij personal, si dhe nga viza e nënshkrimi i shoqërisë.

Neni 64

Ekspertet kontabël të autorizuar duhet të kenë një qendër të përhershme vendosjeje, e cila të dihet nga këshilli i drejtimit të institutit dhe nga klientët.

Neni 65

Në rast vdekjeje të një anëtari të institutit, kryetari i këshillit të drejtimit mundet, me kërkesë të trashëgimtarëve të tij, të caktojë një anëtar të institutit që të administrojë përkohësisht kabinetin e tij, duke përcaktuar edhe kushtet e administrimit.

Neni 66

Çdo ekspert kontabël i autorizuar ose shoqëri e tyre që punëson personel të kualifikuar duhet të marrë në ngarkim stazhierë për ekspert kontabel, të sigurojë formimin e tyre profesional dhe t'i shpërblejë për punën që kryejnë.

Ekspertët kontabël stazhierë duhet të përmbushin detyrimet e stazhit dhe të punës, të thellojnë njohuritë profesionale, të jenë të bindur e të denjë për profesionin dhe t'i nënshtrohen çdo kontrolli nga ana e institutit për qëndrimin dhe punën e tyre.

Një ekspert kontabël stazhierë nuk mund të pranojë një mision të propozuar nga një klient, me të cilin ka qenë në marrëdhënie me rastin e stazhit, nëse nuk kanë kaluar dy vjet nga mbarimi i stazhit, duke përjashtuar rastin kur këshilli i drejtimit është i një mendimi për një mision të tillë.

KAPITULLI 9

DISIPLINA PROFESIONALE, SANKSIONET DHE PROCEDURAT DISIPLINORE

SEKSIONI 1

DISIPLINA DHE SANKSIONET DISIPLINORE

Neni 67

Çdo shkelje e ligjeve, e akteve nënligjore dhe e rregullave profesionale, çdo neglizhencë e rëndë, çdo fakt që vjen ndesh me bindjen nderin, të lejuara nga një anëtar i institutit, person fizik ose shoqëri, edhe kur këto nuk lidhen me ushtrimin e profesionit, përbëjnë një faj disiplinor të ndëshkueshëm me një masë disiplinore.

Neni 68

Masat disiplinore janë:

- këshillimi;
- qortimi;
- vërejtja me shënim në dosar;
- pezullim i përkohshëm për një kohë jo më shumë se pesë vjet;
- fshirja nga lista e institutit, e cila përmban ndalimin përgjithmonë të ushtrimit të profesionit.

Këshillimi, qortimi dhe vërejtja me shënim në dosje bëhen nga këshilli i drejtimit të institutit. Pezullimi i përkohshëm dhe fshirja nga lista e institutit vendosen nga komisioni i disiplinës. Pezullimi i përkohshëm mund të shoqërohet me ndëshkimin plotësues të moszgjedhjes në organet drejtuese të institutit. Pezullimi mund të jetë i përgjithshëm, ose i kufizuar në një a disa kategori shoqërisht.

Eksperti kontabël i autorizuar, objekt i një ndjekjeje disiplinore, mund të ngarkohet me shpenzimet e procedurës përkatëse.

Neni 69

Në rastet kur komisioni i disiplinës ka marrë vendim për pezullimin e përkohshëm ose për fshirjen nga lista të një anëtari të institutit, kryetari i këshillit të drejtimit duhet të njoftojë menjëherë komisionin e regjistrimit dhe shoqëritë, në të cilat anëtari i pezulluar apo i fshirë nga lista ushtron funksionet e tij. Ky i fundit duhet t'i dorëzojë kryetarit të këshillit të drejtimit të gjitha dokumentet për punimet e kryera gjate 10 vjetëve të fundit dhe ato në proces. Kryetari i këshillit të drejtimit vendos për kthimin e këtyre dokumenteve shoqërive përkatëse.

SEKSIONI 2 PROCEDURAT DISIPLINORE

Neni 70

Ankimet ndaj një anëtari të institutit merren nga këshilli i drejtimit, i cili brenda një muaji duhet t'i përcjellë përfaqësuesit mbikqyrës dosjen e anëtarit bashkë me mendimin e këshillit. Përfaqësuesi mbikqyrës studion çështjen nga ana e tij dhe, së bashku me vërejtjet e mendimet e tij, i rikthen dosjen këshillit të drejtimit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e marrjes.

Kryetari i këshillit të drejtimit ia kalon dosjen komisionit të disiplinës, së bashku me dokumentat në një afat e shumta prej tetë ditësh.

Neni 71

Kryetari i komisionit të disiplinës ngarkon një anëtar plotësues të bëjë kërkimet e verifikimet e duhura dhe mund t'i kërkojë të dhëna plotësuese.

Anëtari plotësues i ngarkuar mund t'u kërkojë shoqërive, në të cilat eksperti kontabël i autorizuar kryen funksionet e tij, dhe çdo personi tjetër shpjegime dhe justifikimet e nevojshme, me qëllim që të informojë komisionin e disiplinës.

Kërkimet dhe mbledhja e të dhënave të nevojshme duhet të përfundojnë e shumta për një muaj.

Neni 72

Për hapjen e një procedure disiplinore nga komisioni i disiplinës, kryetari i këtij komisioni

njofton, nëpërmjet sekretariatit të përgjithshëm të këshillit të drejtimit, kryetarin e këtij këshilli, përfaqësuesin mbikqyrës, ekspertin kontabël të autorizuar objekt i procedurës disiplinore dhe autorin e ankesës.

Neni 73

Eksperti kontabël i autorizuar, objekt i ankesës për faj disiplinor, thirret për t'u paraqitur përpara komisionit të disiplinës nga kryetari i komisionit. Ai njoftohet të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes së komisionit, me letër rekomande me kthim përgjigjeje për marrjen e njoftimit.

Në thirrje duhet të tregohen motivet, përndryshe ajo quhet e pavlefshme.

Thirrja për t'u dëgjuar nga komisioni i ekspertit kontabël u bëhet e njohur edhe personave të tjerë të përmendur në nenin 72.

Neni 74

Eksperti kontabël i autorizuar, i thirrur për t'u paraqitur përpara komisionit të disiplinës, mund të marrë dijëni për dosjen përkatëse. Për këtë qëllim ai mund të asistohet nga një këshilltar ose nga një avokat.

Neni 75

Kryetari i komisionit të disiplinës mund t'i kërkojë raportuesit për të paraqitur gojarisht në fillim të seancës së dëgjimit elementët e çështjes.

Komisioni i disiplinës dëgjon autorin e ankesës, nëse ky e kërkon një gjë të tillë. Ai mund të dëgjojë gjithashtu të gjithë dëshmitarët e tjerë dhe të urdhërojë kërkimin e të dhënave të tjera, nëse është e nevojshme.

Ekspertët kontabël të autorizuar, objekt i procedurës disiplinore, mund të paraqesin argumentet e tyre me shkrim ose me gojë.

Neni 76

Vendimet e komisionit të disiplinës u bëhen të njohura personave të përmendur në nenin 72, brenda 15 ditëve nga data e marrjes nëpërmjet sekretariatit të përgjithshëm të këshillit të drejtimit.

Neni 77

Apelimi i vendimit të komisionit të disiplinës bëhet në dhomën e apelit për disiplinën, brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.

Kërkesa për apelim drejtuar dhomës së apelit për disiplinën bëhet me shkrim. Ajo dorëzohet ose i dërgohet sekretarit të përgjithshëm me letër rekomande me kthim përgjigjeje për marrje.

Gjatë kohës së apelimit vendimi i komisionit mbetet pezull përveç rasteve kur komisioni i disiplinës ka vendosur masa urgjente dhe konservuese, të cilat zbatohen menjëherë.

Neni 78

Për shqyrtimin e fakteve dhoma e apelit për disiplinën ndjek të njejtat procedura si ato të parashikuara në nenet 71 deri 76 për komisionin e disiplinës.

Vendimi i dhomës së apelit për disiplinën u bëhet i njohur personave të interesuar në të njejtat kushte si ato të komisionit për disiplinën.

Kundër vendimit të dhomës së apelit për disiplinën mund të bëhet ankesë në gjykatë.

Neni 79

Sekretariati i përgjithshëm i këshillit të drejtimit të institutit mban një regjistër të ekspertëve kontabël të autorizuar që kanë përbërë objekt të masave disiplinore.

Nën kujdesin e kryetarit të këshillit të drejtimit dhe me ndërmjetësinë e sekretarit të përgjithshëm, vendimet përfundimtare për pezullimin e përkohshëm ose fshirjen nga lista e institutit publikohen në një buletin zyrtar të njoftimeve civile e tregtare. Publikimi i vendimeve bëhet pa treguar motive.

Neni 80

Çdo akt ose marrëveshje që synojnë t'u japin mundësi të ushtrojnë profesionin e ekspertëve kontabël të autorizuar të pezulluar ose të fshirë nga lista e institutit, janë të pavlefshme.

KAPITULLI 10 PROGRAMI I PUNËS DHE SHPËRBLIMI

Neni 81

Punimet e kryera nga anëtarët e institutit në ushtrimin e profesionit të tyre shpërblehen nga personat, ose shoqëritë e interesuara. Për këto punime lidhet një marrëveshje me shkrim që përcakton natyrën e misionit, punimet për t'u kryer dhe kushtet e shpërblimit.

Shpenzimet e veçanta për udhëtim e dieta, të kryera nga anëtarët e institutit për llogari të klientëve të tyre, paguhet nga këta të fundit jashtë honorareve.

Shuma e honorareve të anëtarëve të institutit vendoset në marrëveshje me klientët, por me respektimin e parashikimeve të nenit 85 të këtyre rregullave.

Shuma e honorareve duhet të jetë e arsyeshme dhe të përbëjë shpërblimin e drejtë të punës a të shërbimeve të kryera, si dhe të vështirësisë teknike të çështjeve për t'u zgjidhur, duke pasur parasysh cilësinë e tyre, titullin, emrin e mirë dhe përgjegjësinë morale e materiale të anëtarit të institutit.

Honoraret nuk mund të caktohen në asnjë rast në varësi nga rezultati financiar i klientit dhe ndërhyrjes së anëtarëve të institutit.

Neni 82

Kryetari i këshillit të drejtimit duhet të mbikqyrë që parashikimet lidhur me honoraret të respektohen me korrektësi.

Në rast kundërshtimi lidhur me honoraret, anëtarët e institutit duhet t'i drejtohen kryetarit të këshillit të drejtimit i cili, nga ana e tij, mbledh këshillin për të vendosur për shumën e honorareve.

Vendimi i këshillit të drejtimit mund të bëjë objekt rekursi pranë komisionit të disiplinës.

Neni 83

Honoraret duhet të paguhet në të holla dhe përjashtojnë çdo shpërblim tjetër, qoftë edhe indirekt, nga një i tretë me çfarëdo cilësie që të jetë.

Neni 84

Për kontrollin ligjor të llogarive punimet e ekspertit kontabël të autorizuar duhet të përmbajnë të paktën një numër orësh pune të parashikuar në tabelën e mëposhteme, të llogaritura në varësi nga totali i bilancit të shtuar me shumën e të ardhurave nga veprimtaria, pa tatimin mbi vlerën

e shtuar.

Totali i bilancit dhe i të ardhurave nga veprimtaria pa tatimin mbi vlerën e shtuar	Numri i orëve të punës
- deri në 15 milionë lekë	30 - 50 orë
- nga 15 deri në 50 milionë lekë	40 - 70 orë
- nga 50 deri në 100 milionë lekë	60 -100 orë
- nga 100 deri në 200 milionë lekë	90 -150 orë
- nga 200 deri në 400 milionë lekë	130 - 200 orë
- nga 400 deri në 700 milionë lekë	180 - 250 orë
- nga 700 deri një miliard lekë	230 - 300 orë

Për shumat mbi një miliard lekë numri i orëve të punës është 30 orë për çdo 100 milion lekë.

Për bankat, shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit, për shoqëritë e investimeve dhe të zhvillimit numri i orëve të punës caktohet në varësi nga shuma e kapitalit dhe e rezervave plus të ardhurat nga veprimtaria, pa tatimet.

Neni 85

Këshilli i drejtimit të institutit harton çdo vit një tabelë treguese të tarifave orare të shpërblimit, që zbatohen nga 1 Janari i çdo viti për punimet normale të kontrollit ligjor të llogarive. Këto tabela miratohen nga Ministri i Financave.

Tarifat orare minimum mund të tejkalohen e shumta 20 për qind, duke pasur parasysh kushtet specifike të shoqërisë që kontrollohet, si dhe të organizimit të ekspertit kontabël të autorizuar.

Neni 86

Në rastet kur ekspertët kontabël të autorizuar do të kryejnë punime të tjera mbi ato të parashikuara në programin e caktuar fillimisht, sipas kërkesës së shoqërisë dhe të organeve gjyqësore, numri i orëve të punës mund të shtohet e shumta me një të tretën e orëve të vendosura fillimisht. Në këto raste tarifat orare të orëve suplementare caktohen lirisht ndërmjet ekspertit kontabël të autorizuar dhe kërkuarit.

Neni 87

Në rastet e ndryshimeve të indekseve ligjore të çmimeve, shpërblimi vjetor i ekspertëve kontabël të autorizuar që duhet të paguajë shoqëria për kontrollin ligjor të llogarive, ndryshon në të njëjtin përpjestim, duke nisur nga data e ndryshimit të indeksit.

Neni 88

Në rastin kur shoqëria kontrollohet nga dy a më shumë ekspertë kontabël të autorizuar, shpërblimi total për kontrollin ligjor të llogarive është i barabartë me atë të një eksperti, i shtuar me 40 për qind për çdo ekspert kontabël të autorizuar plotësues. Ekspertët kontabël të autorizuar e ndajnë në mënyrë të barabartë ndërmjet tyre shpërblimin total.

Neni 89

Kur eksperti kontabël i autorizuar i një shoqërie kryen në të njëjtën kohë kontrollin ligjor të

një a disa filialeve të shoqërisë, shuma e honorareve për çdo filial është e barabartë me shumën që del nga zbatimi i tabelës normale, e pakësuar me 30 për qind.

Neni 90

Në rast zëvendësimi gjatë ushtrimit ndarja e honorareve ndërmjet ekspertit kontabël të zëvendësuar dhe atij zëvendësues bëhet përpjestimisht me kohën e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre.

Neni 91

Ekspertëve kontabël të autorizuar u ndalohet të pranojnë honorare më të ulta nga honoraret minimum të treguara më sipër. Në rast shkeljeje të kësaj dispozite, komisioni i disiplinës, me kërkesë të kryetarit të këshillit të drejtimit mund të ndëshkojë nga ana disiplinore ekspertin kontabël deri në fshirjen nga lista e institutit.

Neni 92

Këto rregullime hyjnë në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr. 155, datë 7.4.2000

PËR PROKURIMIN E DREJTPËRDREJTË TË FONDEVE PËR FURNIZIMIN ME USHQIM TË EFEKTIVIT TË APARATIT TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK DHE TË EFEKTIVIT QË TRAJNOHET NË QENDRËN E TRAJNIMIT NË DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, neni 17, pika 3, dhe të nenit 37, pika 1, të ligjit nr.7971, datë 27.6.1995, "Për prokurimin publik", me propozimin e ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Autorizohet Ministria e Rendit Publik të prokurojë, me procedurën e prokurimit të drejtpërdrejtë, fondin prej 30 milionë lekësh, për furnizimin me ushqim të efektivit të aparatit të Ministrisë së Rendit Publik dhe të efektivit që trajnohet në qendrën e trajnimit, në Durrës.

Trajtimi me ushqim i efektivit të aparatit të Ministrisë së Rendit Publik, të bëhet në Klubin e Ministrisë së Rendit Publik, ndërsa për efektivin e qendrës së trajnimit, në Durrës trajtimi të bëhet në shtëpinë e pushimit të Ministrisë së Rendit Publik, po në Durrës.

2. Fondi prej 30 milionë lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2000, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

3. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 204, datë 29.4.2000

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN, NR.627, DATË 24.12.1997, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 10 të Kushtetutës, të nenit 8, të ligjit nr.8405, datë 19.9.1998, “Për urbanistikën”, dhe të neneve 2 dhe 16, të ligjit nr.7867, datë 12.10.1994, “Për mbrojtjen e pasurisë kulturore, të luajtshme dhe të paluajtshme”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.627, datë 24.12.1997, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si vijon:

“Këshilli i Rregullimit të Territorit të Shqipërisë përbëhet nga 14 anëtarë.”.

2. Në pikën 4, të shtohet: “Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”.

3. Në “Rregulloren për funksionimin e KRRTSH-së” të bëhen ndryshimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 208, datë 29.4.2000

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.651, DATË 18.10.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr.7550, datë 20.1.1992, “Për policinë e objekteve”, të nenit 21, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.651, datë 18.10.1998, të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

“Në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet vendimit, pas pikës 8 shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

“9. Banka e Shqipërisë dhe filialet e saj në rrethe, objekti “X79” dhe “X88”, Tiranë.”.

Në lidhjen nr.2, që po ashtu i bashkëlidhet vendimit, hiqen pikat 1 dhe 2.”.

2. Për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi, në limitin organik të Ministrisë së Rendit Publik shtohen 78 punonjës policie dhe në buxhetin e saj për vitin 2000 shtohen 37 000 000 lekë, të cilat përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 211, datë 5.5.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.704, DATË 7.11.1998, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME SHPËRBLIM TË USHTARAKËVE TË SISTEMIT
TË RENDIT PUBLIK, BRIGADËS KOMANDO DHE POLICISË USHTARAKE”.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr.8435, datë 28.12.1998, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 4 e vendimit nr.704, datë 7.11.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me shpërblim të ushtarakëve të sistemit të rendit publik, brigadës komando dhe policisë ushtarake”, ndryshohet si vijon:

“Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Drejtësisë u jepen përkatësisht 84%, 10%, dhe 6%, të shumës së arkëtuar nga tatimi i vendosur me ligjin nr.8419, datë 28.10.1998”.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2000, fondi limit i të ardhurave prej 90 000 mijë lekësh i pakësohet Ministrisë së Rendit Publik dhe i shtohet Ministrisë së Drejtësisë.

3. Ministria e Drejtësisë të përcaktojë kriteret dhe masën e shpërblimit për çdo funksion.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij shtrihen nga data 1.1.2000.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.213, datë 5.5.2000

PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË NDRIÇIMIT TË DISA QYTETEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, ministrit të Financave edhe ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për përmirësimin e sistemit të ndriçimit të disa qyteteve të vendit, bashkive u jepen fondet si më poshtë:

- Bashkisë së Vlorës	16	milionë lekë
- Bashkisë së Shkodrës	5	milionë lekë
- Bashkisë së Beratit	5	milionë lekë
- Bashkisë së Sarandës	2.5	milionë lekë
- Bashkisë së Delvinës	2	milionë lekë
- Bashkisë së Durrësit	7	milionë lekë

- Bashkisë së Pogradecit	3.5 milionë lekë
- Bashkisë së Mirditës	2 milionë lekë
- Bashkisë së Burrelit	2 milionë lekë
- Bashkisë së Bulqizës	1 milionë lekë
- Bashkisë së Kuçovës	2 milionë lekë
- Bashkisë së Poliçanit	4 milionë lekë
- Bashkisë së Gjirokastrës	6 milionë lekë
- Bashkisë së Tiranës	10 milionë lekë
- Bashkisë së Pukës	2 milionë lekë
- Bashkisë së Tepelenës	2 milionë lekë
- Bashkisë së Lushnjës	4 milionë lekë
- Bashkisë së Fierit	4 milionë lekë

Gjithsej 80 milionë lekë

2. Fondet e mësipërme të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 216, datë 5.5.2000

**PËR SHPËRBLIMIN E CILËSISË SË LARTË SPORTIVE TË PESHËNGRITËSAVE
SHQIPTARË DHE PËR PËRGATITJEN E TYRE PËR LOJËRAT OLIMPIKE
“SIDNEY 2000”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë“ dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2000, i shtohet shuma prej 6 milionë lekësh, për shpërblimin e cilësisë së lartë sportive, të arritur nga sportistët tanë në ngjarjet e fundit, botërore e europiane, të peshëngritjes dhe për përgatitjen e tyre për Lojërat Olimpike “Sidney 2000”.

2. Shuma e mësipërme të ndahet si vijon:

a) Peshëngritësi Ilirjan Suli, për rezultatet e larta të arritura në Kampionatin European të peshëngritjes, ku u shpall nënkampion i Europës, shpërblehet me 3 milionë lekë.

b) Peshëngritësi Ilir Kafarani, për rezultatet e larta të arritura në Kampionatin Botëror të peshëngritjes dhe për paraqitjen dinjitoze në Kampionatin European shpërblehet me 2 milionë lekë.

c) Pavarësisht nga të ardhurat e tjera, mbështetja financiare e këtyre peshëngritësve, deri në prag të Lojërave Olimpike “Sidney 2000”, të jetë 100 000 lekë në muaj.

ç) shuma prej 200 000 lekësh të përdoret për sistemin e veçantë të peshëngritësve, për trajtimin mjekësor, fizioterapeutik dhe vitaminoz dhe për nevoja të tjera, me interes sportiv në dobi

të tyre.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 217, datë 5.5.2000

PËR KONTROLLIN FINANCIAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997, "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përmbajtja, organet dhe objekti.

1.1. Kontrolli financiar, si pjesë përbërëse e kontrollit të përgjithshëm shtetëror, është një instrument i domosdoshëm drejtimi, një funksion i pavarur vlerësimi, i krijuar brenda subjektit, për të vlerësuar veprimtarinë e tij në formë shërbimi. Ai ka për qëllim të mbrojë subjektin nga të gjitha llojet e dëmtimeve e të humbjeve financiare dhe të garantojë, në shkallën më të lartë, përdorimin e burimeve.

1.2. Kontrolli financiar në Republikën e Shqipërisë përfaqësohet nga:

1. Departamenti i Kontrollit Financiar, në Ministrinë e Financave.
2. Departamenti i Kontrollit Financiar në Ministrinë e Pushtetit Lokal.
3. Drejtoritë e kontrollit financiar në ministritë dhe institucionet qendrore, në bankat e nivelit të dytë, në institucionet financiare me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind.
4. Drejtoritë e kontrollit financiar në prefektura.
5. Zyrat e kontrollit financiar në njësitë e qeverisjes vendore, në ndërmarrjet e në institucionet shtetërore, shoqëritë tregtare, me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind.

1.3. Të gjitha ministritë, institucionet qendrore, ndërmarrjet dhe institucionet e tjera janë të detyruara të ngrënë strukturat e kontrollit financiar, në përputhje me pikën 2 dhe me normat e ngarkesës së caktuar nga Departamenti i Kontrollit Financiar në Ministrinë e Financave. U këshillohet organeve të qeverisjes vendore të ngrënë strukturat e kontrollit të brendshëm.

1.4. Objekti i kontrollit financiar është garantimi i drejtuesit, se objektivat e përcaktuara po arrihen se veprimtaria e subjektit është në përputhje me kërkesat dhe rregullat, e brendshme e të jashtme, se subjekti ruan burimet (e buxhetit, e kapitalit shtetëror, si dhe burimet) në një mënyrë të tillë që nxit operacionet ekonomike në mënyrë të frytshme dhe me rezultat, se të dhënat financiare dhe të drejtimit të subjektit janë të sakta dhe të plota.

2. Detyrat dhe të drejtat e organeve të kontrollit financiar

2.1. Departamenti i Kontrollit Financiar, në Ministrinë e Financave, ka këto detyra kryesore:

1. Realizon dhe përgjigjet për udhëheqjen metodologjike të Kontrollit Financiar, në shkallë vendi, dhe mbikëqyr veprimtarinë e tij, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me ato të përcaktuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

2. Organizon dhe kryen kontrollin në objektet e varësisë së drejtpërdrejtë, si në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në atë të doganave, në bankat e nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror ose me pjesëmarrje të tij mbi 50 për qind, në institucionet financiare, të shndërruara ose jo në shoqëri anonime, me kapital shtetëror ose me pjesëmarrje të tij mbi 50 për qind, në degët e

thesarit dhe të buxhetit në rrethe etj.

3. Për probleme të veçanta dhe të rëndësishme, me urdhër të qeverisë, Departamenti i Kontrollit Financiar, mund të ushtrojë kontroll në të gjithë sistemin e ministrive dhe në institucionet qendrore të pushtetit ekzekutiv.

4. Një herë në gjashtë muaj boton një buletin për problemet që kanë dalë nga kontrollat e kryera dhe për përvojën dhe përsosjen e teknikave të kontrollit.

5. Një herë në vit, nëpërmjet ministrit të Financave, i paraqet qeverisë një raport për gjendjen e kontrollit financiar dhe për problemet e tij.

2.2. Departamenti i Kontrollit Financiar në Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe drejtoritë e kontrollit financiar në ministrinë, institucionet qendrore dhe në prefekturat kanë këto detyra kryesore:

1. Organizimin dhe kryerjen e kontrollit në objektet e varësisë së drejtpërdrejtë dhe ato të caktuara me ligj.

2. Përcaktimin e metodikave të veçanta për kontrollin e subjekteve varëse dhe ato të linjës.

3. Përgjithësimin e problemeve të dala nga kontrollat e ushtruara, duke i paraqitur, një herë në muaj, raport titullarit të ministrisë apo të institucionit qendror dhe një herë në tre muaj Departamentit të Kontrollit financiar, në Ministrinë e Financave, sipas afateve të përcaktuara nga kjo e fundit.

4. Ministria e Pushtetit Lokal, me anë të strukturës së saj të kontrollit, ka për detyrë të ushtrojë kontroll-revizion të përgjithshëm në prefektura jo më pak se një herë në vit. Për probleme të veçanta, me urdhër të ministrit përkatës, ajo mund të ushtrojë kontroll edhe të drejtpërdrejtë në njësitë e qeverisjes vendore, duke respektuar pavarësinë e tyre.

5. Drejtoritë e kontrollit financiar në prefektura, sipas ligjit, kanë për detyrë të mbulojnë me kontroll-revizion të përgjithshëm, brenda vitit, të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, si dhe ndërmarrjet e institucionet, në varësi të pushtetit vendor.

2.3. Organet e kontrollit financiar, gjatë ushtrimit të kontrolleve, kanë këto të drejta:

1. Të ushtrojnë kontroll në përputhje me kërkesat e standardet e kontrollit dhe sipas përgjegjësisë të përcaktuara në këtë vendim.

2. Të përdorin lirisht dhe pa kufizim të gjitha të dhënat ekonomike, financiare, teknike dhe të drejtimit të subjektit që kontrollohet, duke marrë përsipër ruajtjen e të dhënave me karakter sekret. Ato kontrollojnë dhe vlerësojnë saktësinë dhe plotësinë e të dhënave.

3. Të tërheqin, për nevojat e kontrollit, kopje të dokumenteve ose origjinalin e tyre, kundrejt vërtetimit të lëshuar.

4. Të hyjnë dhe të verifikojnë në vend, në depo vendore ose subjekte, pa asnjë kufizim, të vlerësojnë dhe kontrollojnë kudo ku ka vlera materiale e monetare.

5. Vlerësojnë dhe kontrollojnë përdorimin me frytshmëri të burimeve financiare.

6. Marrin vendime të përkohshme dhe kurdoherë të arsyetuara me shkrim për ndalimin e përkohshëm të veprimeve që bien ndesh me ligjet e shtetit ose çenojnë interesat ekonomike të tij, deri në shqyrtimin përfundimtar të organeve përkatëse, që i kanë në përgjegjësi.

Të drejtën për të marrë vendime për ndalim të përkohshëm e kanë drejtuesit e strukturës së kontrollit ministri, institucione qendrore dhe prefektura, me propozimin e arsyetuar të kontrollorit.

7. Në bashkëpunim me subjektin përcaktojnë detyra e zgjidhje për rregullimin e gjendjes, ndreqjen e parregullsive.

8. I propozojnë titullarit të subjektit nga i cili varet kontrolli masa me karakter administrativ e disiplinor dhe zhdëmtimin e punonjësve të kontrolluar.

2.4. Organet e kontrollit financiar, të përcaktuara në pikën 1.2, janë të detyruara të ushtrojnë kontroll të përgjithshëm në objektet e varësisë së tyre jo më pak se një herë në vit. Ky detyrim përfshin edhe $\frac{1}{4}$ e filialeve apo të degëve të objekteve të organizuara me bilanc.

2.5. Rregullat e përgjithshme për organizimin dhe kryerjen e kontrollit caktohen me udhëzimin e Ministrisë së Financave.

2.6. Kur gjatë kontrollit zbulohen vepra penale, mungesa, përvetësime apo shkelje disiplinore financiare, kontrollori është i detyruar të mbajë proces-verbal, për personat që janë

përfshirë në to, duke përcaktuar karakterin e shkeljes, shumën e dëmit të rrjedhur, në qoftë se ka, dispozitën që është shkelur dhe personin i cili duhet të përgjigjet.

Kur shkeljet e vëna re formojnë vepra penale, titullari i organit që ka strukturën e kontrollit, është i detyruar që, brenda 15 ditëve nga shqyrtimi i raportit të kontrollit, të bëjë kallzim në organet e prokurorisë.

2.7. Brenda 15 ditësh nga paraqitja e raportit, ministri, drejtuesi i organit qendror, prefekti si dhe drejtuesit e njësive të qeverisjes vendore, të ndërmarrjeve e institucioneve të tjera janë të detyruar të nxjerrin urdhëra për përfundimet e kontrollit.

2.8. Kontrollori mban përgjegjësi disiplinore, materiale ose penale për zbatimin e programit të kontrollit, saktësinë e rezultateve e të përfundimeve të tij.

3. Pranimi në organet e kontrollit dhe trajtimi financiar

3.1. Përveç kriterëve të përgjithshme, të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr.8549 datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit të shërbimit civil", në organet e kontrollit financiar mund të pranohen vetëm ata që kanë mbaruar studimet e larta në fushën e ekonomisë dhe të drejtësisë dhe kanë një stazh pune në profesion jo më pak se 5 vjet.

3.2. Në organet e ulta të kontrollit financiar, si në ndërmarrje e institucione të vogla, mund të pranohen, përjashtimisht, edhe specialistë me arsim të mesëm ekonomik, që kanë një përvojë pune në profesion jo më pak se 10 vjet.

Gjithashtu, në mënyrë të kufizuar, sipas kërkesave të organit të kontrollit, në ministri dhe institucione qendrore mund të pranohen edhe specialistë të fushave të tjera, si inxhinierë, teknologë etj.

3.3. Punonjësit e kontrollit nuk mund të ngarkohen të kryejnë detyra të tjera operative, të cilat nuk lidhen me ushtrimin e kontrollit dhe të detyrave që ato mbulojnë, brenda subjektit ose në subjekte të varësisë. Ata njëkohësisht, nuk mund të kryejnë detyra të tjera jashtë punës, të cilat krijojnë konflikte interesash me funksionin e tyre.

3.4. Për vitin 2000 struktura organizative dhe numri i punonjësve të Departamentit të Kontrollit Financiar, në Ministrinë e Financave, është si më poshtë:

1. Drejtor.
2. Sektori i kontrollit të drejtimit (inspektoriati).
3. Sektori i kontrollit të objekteve të varësisë së drejtpërdrejtë.
4. Sektori i organizimit dhe i metodikave.
5. Zyra e statistikës dhe e përgjithësimit.

Numri i punonjësve të Departamentit të Kontrollit financiar të jetë 25.

- Ndërsa në Departamentin e Kontrollit Financiar në Ministrinë e Pushtetit Lokal struktura organizative të jetë si më poshtë:

1. Drejtor departamenti.
2. Sektori i kontroll revizionit të prefekturave.
3. Sektori i bashkërendimit, kualifikimit dhe përgjithësimit.

- Ministrisë së Pushtetit Lokal i shtohen në Departamentin e Kontrollit edhe 10 punonjës, nga të cilët 2 shoferë.

3.5. Për efekt të pagave bëhet njësimi i mëposhtëm:

1. Departamenti i Kontrollit Financiar, në Ministrinë e Financave dhe Departamenti i Kontrollit Financiar në Ministrinë e Pushtetit Lokal njësohen me drejtoritë rajonale, të kategorisë së parë, të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Pagat e punonjësve në drejtorinë e kontrollit financiar, në ministri dhe institucione qendrore, banka të nivelit të dytë e institucionet financiare nuk mund të jenë më të vogla se ato të punonjësve të drejtorisë rajonale, të kategorisë së dytë, të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

3. Pagat në drejtoritë e kontrollit financiar në prefektura njësohen me pagat e drejtorive rajonale, të kategorisë së tretë, të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

4. Pagat e punonjësve në zyrat e kontrollit financiar në njësitë e qeverisjes vendore, në ndërmarrje e institucione vendore njësohen me pagat e inspektorëve të kategorisë së dytë, në degët

rajonale të kategorisë së tretë, të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në këto raste paga e drejtuesit të kësaj strukture është 15 për qind mbi nivelin më të lartë të specialistit.

Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike të ndërtojë tabelat e pagave dhe klasifikimin përkatës, sipas kriterëve të mësipërme.

3.6. Identiteti i punonjësve të kontrollit vërtetohet me kartën përkatëse, e cila ka formën e përcaktuar nga Departamenti i Kontrollit Financiar, në Ministrinë e Financave, dhe është e nënshkruar nga ministri, drejtuesi i organit qendror, prefekti ose drejtuesi i njësisë së qeverisjes vendore, ndërmarrjes apo institucionit.

3.7. Shtesa e numrit të punonjësve si dhe efektet financiare do të përballohen në këtë mënyrë:

Për Ministrinë e Financave, Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe për prefekturat nga pakësimi i numrit të punonjësve dhe nga buxheti i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Për ministritë dhe institucionet e tjera qendrore nga buxheti i tyre.

3.8. Ngarkohen ministritë, institucionet qendrore, prefekturat dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

3.9. Ngarkohet Ministria e Financave për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

4. Urdhëresa nr.2, datë 2.12.1992, "Për kontroll-revizionin ekonomiko-financiar", si dhe vendimi nr.162, datë 7.5.1992, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin e drejtorisë së kontroll-revizionit ekonomiko-financiar, në përbërje të Komisionit të Kontrollit të Shtetit", vendimi nr.180, datë 4.5.1994, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin e seksioneve të kontrollit të komiteteve ekzekutive në bashki", si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ngarkohet Ministria e Financave, që brenda vitit 2000, të paraqesë në qeveri projektligjet "Për kontrollin e brendshëm" dhe "Për qarkullimin dhe dokumentimin e vlerave materiale e monetare".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 224, datë 5.5.2000

PËR SHPRONËSIMIN DHE KOMPENSIMIN E TOKËS BUJQËSORE TË FAMILJEVE TË FSHATRAVE ZALLMNER DHE BULCESH, QË PËRMBYTEN NGA UJËMBLEDHËSI I BOVILLËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 dhe 9, të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994, "Për shpronësimin për interes publik, si dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme", me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin dhe kompensimin e tokës bujqësore, prej 395 052 m², të 57 familjeve të fshatrave Zallmner dhe Bulcesh, që përmyten nga ujëmbledhësi i Bovillës, me vlerë të përgjithshme 237 031 200 (dyqindetridhjeteshtatë milionë e tridhjetenjë mijë e dyqind) lekë.

2. Ministria e Punëve Publike, me fondin e programuar prej 118 515 600 (njëqindetëmbëdhjetë milionë e pesëqindpesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekësh në buxhetin e shtetit të vitit 2000, të bëjë likuidimin e pjesshëm.

3. Ngarkohet Komuna e Zall Bastarit, në Tiranë, për realizimin e pagesave të familjeve në fshatrat Bulcesh dhe Zallmner, sipas listave që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Shpronësimi të kryhet brenda vitit 2001.
 5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe këshilli i rrethit të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Lista emërore e kryefamiljarëve të familjeve të Komunës Zall Bastar që janë parashikuar të sistemohen në qytet sipas VKM Nr.317, datë 19.06.1995 që nuk janë kompensuar me tokë bujqësore

Nr.	Emri, Mbiemri	Sip. e tokës sipas pronësisë në m ²	Njësia lekë/m ²	Vlera në lekë	Koeficienti	Vlera që do të marrin familjet
A	B	c	d	e	f	g
I.	Fshati Zall-Mner	1900210	600	114126000	0.5	57063000
1.	Musa Limani	1840	600	1104000	0.5	552000
2.	Kujtim Ibrahim	5340	“	3204000	“	1602000
3.	Avdi Gega	9400	“	5640000	“	2820000
4.	Hasan Gega	5520	“	3312000	“	1656000
5.	Asllan Tafa	5520	“	3312000	“	1656000
6.	Xhevahir Tafa	3680	“	2208000	“	1104000
7.	Kujtim Sita	3680	“	2208000	“	1104000
8.	Bajram Tafa	7360	“	4416000	“	2208000
9.	Ilir Lila	3680	“	2208000	“	1104000
10.	Lutfi Lami	9200	“	5520000	“	2760000
11.	Hane Lami	3680	“	2208000	“	1104000
12.	Selman Elezi	9200	“	5520000	“	2760000
13.	Riza Grezi	6000	“	3600000	“	1800000
14.	Haxhi Elezi	7360	“	4416000	“	2208000
15.	Ymer Elezi	7360	“	4416000	“	2208000
16.	Selim Abazi	9200	“	5520000	“	2760000
17.	Xhemal Musai	9200	“	5520000	“	2760000
18.	Haki Lami	5520	“	3312000	“	1656000
19.	Halil Lami	7360	“	4416000	“	2208000
20.	Shaban Gega	4000	“	2400000	“	1200000
21.	Sylejman Hysa	9200	“	5520000	“	2760000
22.	Hamdi Demiri	18400	“	11040000	“	5520000
23.	Rexhep Hyseni	14400	“	8640000	“	4320000
24.	Qerim Abazi (Gjoni)	7550	“	4530000	“	2265000
25.	Zenel Tafa	9200	“	5520000	“	2760000
26.	Qamil Tafa	7360	“	4416000	“	2208000
II.	Fshati Bulcesh	204842	600	122905200	0.5	61452600
1.	Demir Ahmeti	6800	600	4080000	0.5	2040000
2.	Hysen Sala	3400	“	2040000	“	1020000

3.	Astrit Sala	1720	“	1032000	“	516000
4.	Selim Ibrahim	8000	“	4800000	“	2400000
5.	Musa Ibrahim	6880	“	4128000	“	2064000
6.	Lutfi Mucalla	3440	“	2064000	“	1032000
7.	Hysen Hoxha	6966	“	4179600	“	2089800
8.	Ferid Hoxha	3440	“	2064000	“	1032000
9.	Anife Aruci	10140	“	6084000	“	3042000
10.	Isuf Basha	6800	“	4080000	“	2040000
11.	Hazis Basha	10200	“	6120000	“	3060000
12.	Emin Basha	3400	“	2040000	“	1020000
13.	Ahmet Hoxha	12040	“	7224000	“	3612000
14.	Nuri Hoxha	6880	“	4128000	“	2064000
15.	Osman Hoxha	8600	“	5160000	“	2580000
16.	Beqir Hoxha	12488	“	7492800	“	3746400
17.	Ibrahim Hoxha	8800	“	5280000	“	2640000
18.	Enver Hoxha	12040	“	7224000	“	3612000
19.	Ismail Hoxha	5100	“	3060000	“	1530000
20.	Sanie Hoxha	12040	“	7224000	“	3612000
21.	Bihane Bruzi	1720	“	1032000	“	516000
22.	Shaqir Bruzi	1720	“	1032000	“	516000
23.	Naxhije Dajti	6880	“	4128000	“	2064000
24.	Asllan Cali	5100	“	3060000	“	1530000
25.	Kujtim Basha	1720	“	1032000	“	516000
26.	Shefqet Dervishi	1720	“	1032000	“	516000
27.	Ramazan Basha	18125	“	10875000	“	5437500
28.	Asllan Basha	6663	“	3997800	“	1998900
29.	Ibrahim Cali	1700	“	1020000	“	510000
30.	Hava Cali	5160	“	3096000	“	1548000
31.	Fatmir Hoxha	5160	“	3096000	“	1548000
Totali fshati						
Zallmner + fshati Bulcesh		395052	600	237031200	0.5	118515600

V E N D I M
Nr. 225, datë 5.5.2000

PËR LIKUIDIMIN NË RRUGË ADMINISTRATIVE TË NDËRMARRJES “FONDERIA E UZINËS MEKANIKE”, TIRANË, DHE PËRBALLIMIN E PAGESËS SË PUNONJËSVE QË MBETEN PA PUNË NGA LIKUIDIMI I SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 48, pika 1, të ligjit nr.8017, datë 25.10.1995, “Për procedurat e falimentimit”, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000” dhe të nenit 4, të ligjit nr.7926, datë 10.5.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Organi i pushtetit vendor, që ka të drejtën e përfaqësuesit të pronarit për pronën

shtetërore, të përfundojë procedurat administrative, për likuidimin, në rrugë administrative, të ndërmarrjes “Fonderia e uzinës mekanike”, Tiranë.

2. Punonjësit, të cilët mbeten pa punë, sipas listës që i bashkëlidhet vendimit, nga likuidimi administrativ i ndërmarrjes “Fonderia e uzinës mekanike”, Tiranë, për shkak të ndërtimit në territorin e saj të Gjykatës së Tiranës, do të marrin pagën mesatare vjetore (të vitit 1999) për një periudhë njëvjeçare duke filluar nga data e likuidimit të ndërmarrjes.

3. Të drejtën për t’u trajtuar sipas pikës 2 të këtij vendimi e përfitojnë të gjithë punonjësit që kanë qenë të punësuar në këtë ndërmarrje pandërprerje, për një periudhë kohe jo më pak se 2 vjet, e që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike, në formën e punësimit apo të vetëpunësimit, apo që familjet e tyre nuk kanë tokë në pronësi apo në përdorim si dhe janë të gatshëm dhe pranojnë të marrin pjesë në punë të nevojshme publike, të organizuara në nivel vendor.

4. Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2000, i shtohet fondi përkatës për pagesën e papunësisë, në masën prej 2, 085 milionë lekësh. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

5. Periudha e pagesës së punonjësve, sipas këtij vendimi, të llogaritet si vjetërsi pune për efekt pensioni dhe të shënohet si e tillë në librezën e punës. Për punonjësit e trajtuar sipas këtij vendimi të derdhen të gjitha kontributet, siç përcaktohet në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

6. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të parashikojë në projektbuxhetin e vitit 2001 fondin e nevojshëm për pagesën e punonjësve të trajtuar sipas pikës 3 të këtij vendimi.

7. Pagesat kryhen nga zyra e punës, në bazë të dokumentacionit të përcaktuar me udhëzimin e veçantë të zëvendëskryeminitrit dhe ministër të Punës dhe Çështjeve Sociale.

8. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Drejtësisë dhe bashkia e Tiranës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

9. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**MINISTRIA E PUSHTETIT LOKAL
BASHKIA TIRANE
FONDERIA E UZINES MEKANIKE
TIRANE**

Pasqyra e pages mesatare dhe vjetërsia ne pune e punonjesve qe aktualisht punojne ne fonderine e Uzines Mekanike.

Nr.	Emër Mbiemër	Viti i lindjes	Paga mesatare	Vjetërsia	Profesioni	Afati i daljes në pension
1.	Mimoza Qirici	07.06.57	17970	20	Ing.Metalurg	
2.	Lule Canaj	12.05.53	12615	27	Ing Kimist	
3.	Entela Keta	15.06.71	17750	5	Financier	
4.	Qerim Ismeni	01.01.51	11530	26	Ing.Metalurg	
5.	Lume Cela	28.02.54	10130	30	Magazine	
6.	Riza Kadiu	01.12.51	10517	30	Fonditor	
7.	Naim Çela	30.12.59	10510	17	Fonditor	
8.	Bashkim Përmeti	08.06.52	10315	31	Fonditor	
9.	Shpetim Kurti	22.02.67	10475	16	Fonditor	
10.	Qemal Shaba	09.08.53	10376	30	Fonditor	

11.	Hamdi	Krasniqi	05.05.57	9155	27	Fonditor
12.	Arben	Teli	14.02.60	11880	23	Fonditor
13.	Gezim	Iljazi	28.08.42	11431	41	Fonditor
14.	Abdulla	Rreli	07.04.43	11240	35	Fonditor
15.	Gezim	Ballushi	10.12.49	10723	32	Fonditor
16.	Fatmir	Veseli	05.09.59	10437	24	Fonditor
17.	Ylli	Çuadari	17.01.48	10645	34	Fonditor
18.	Hysen	Shameti	05.08.40	10450	40	Fonditor
19.	Iljaz	Hasani	01.01.36	10000	46	Fonditor
20.	Njazi	Dado	24.03.39	10000	47	Fonditor
21.	Skender	Bukri	03.03.53	10400	31	Fonditor
22.	Skender	Laska	06.03.60	10450	17	Fonditor
23.	Refik	Hoxha	16.02.67	9900	10	Fonditor

Shuma mesatare mujore në lekë 258.899

VENDIM
Nr. 226, datë 5.5.2000

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË
SHËRBIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 3, të vendimit nr.335, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

- “- Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë;
- Presidenti i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë;
- Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare;
- Kryegjyshi i Kryegjyshit Botërore Bektashiane.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 228, datë 5.5.2000

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.731, DATË 11.11.1998, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E DREJTORISË SË KONTROLLIT TË
BRENSHËM ADMINISTRATIV”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11 dhe 18, të ligjit nr.8549, datë 13.5.1999, “Për statusin e nëpunësit civil”, dhe të nenit 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për

kompetencat për caktimin e pagave të punës” me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.731, datë 11.11.1998, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si vijon:

- Emërtimi “Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm Administrativ” ndryshohet dhe emërtohet “Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ”.

- Pika 2 shfuqizohet.

- Në pikën 3 shtohen paragrafet:

“e) Studimi dhe vëzhgimi i problemeve dhe i dukurive të fushës së ekonomisë, financës, privatizimit, rendit, mbrojtjes, arsimit, kulturës, çështjeve sociale dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, pas daljes së vendimeve të Këshillit të Ministrave.”.

ë) Propozimin për përgatitjen e akteve të nevojshme, juridike, për zhdukjen e mosbashkërendimit dhe të konflikteve të interesave, ndërmjet organeve të ndryshme shtetërore.”.

- Pas pikës 10 shtohet pika 10.1, me këtë përmbajtje:

“Në vendimin nr.1999, datë 22.4.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për rritjen e pagave të punonjësve të institucioneve buxhetore”, bëhen këto ndryshime:

“1. Në lidhjen nr. 1 renditja e funksioneve sipas klasifikimit në shkronjën A 11 shtohet emërtimi “drejtori i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ në Këshillin e Ministrave”, në shkronjën B2 shtohet emërtimi “Inspektor i kontroll-bashkërendimit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ, në Këshillin e Ministrave”, në shkronjën C2 shtohet emërtimi “Asistent i inspektorit të kontroll-bashkërendimit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ, në Këshillin e Ministrave.”.

2. Në lidhjen II 4 “Nivelet e pagës sipas funksioneve në Këshillin e Ministrave në numrin rendor 7 shtohet emërtimi “Drejtori i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ, në Këshillin e Ministrave”, në numrin rendor 9 shtohet emërtimi “Inspektor i kontroll-bashkërendimit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ, në Këshillin e Ministrave”, në numrin rendor 14 shtohet emërtimi “Asistent i inspektorit të kontroll-bashkërendimit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ, në Këshillin e Ministrave.”.

Fondi i pagave të Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ përballohet nga buxheti i vitit 2000, i miratuar për aparatën e Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M

Nr. 229, datë 5.5.2000

PËR MASËN E MBULIMIT TË ÇMIMIT TË BARNAVE QË RIMBURSOHEN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Masa e mbulimit të çmimeve të listës së barnave që rimbursohen, sipas grupeve, është:

Grupi I-100%

- Antineoplazmikë (për mjekimin e sëmundjeve tumorale)
- Antituberkularë (për mjekimin e TBC-së)

Grupi II-75-99%

- Analgjezike dhe antipiretike
- Antineoplazmike
- Antiinfektive
- Antiparkinsonike
- Demartologjike
- Hormone, kontraktivë, endokrinologji
- Miorelaksant
- Oksitocike dhe antioksidocike
- Psikotrope
- Veprojnë në rrugët e frymëmarrjes
- Vitamina e kripëra minerale
- Antiepileptike

Grupi III-55-74.5%

- Antidote
- Të hematologjisë
- Kardiovaskular
- Gastrointestinal
- Oftalmologji

Grupi IV-23-54.9%

- Antialergjikë
- Antimigrenozë
- Diuretikë

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve Shëndetësore për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi nr.798, datë 24.12.1998, i Këshillit të Ministrave, "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.54, datë 2.2.1996, "Për listën e barnave që rimbursohen dhe masën e mbulimit të çmimit të barnave", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	" "
Alferd Karamuço,	Anëtar i	" "
Bardha Selenica,	Anëtare e	" "
Kristofor Peçi,	Anëtar i	" "
Kujtim Puto,	Anëtar i	" "
Sokol Sadushi,	Anëtar i	" "
Hajredin Fuga,	Anëtar i	" "

me sekretare Drita Filto, në datat 04.10. 1999 dhe 28. 01. 2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr. 56/1 Akti, që i përket:

KËRKUESE: SHOQATA "BARAZI PARA LIGJIT", e përfaqësuar nga avokati Stavri

Çeço, me prokurë .

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. SHOQATA KOMBËTARE E TË SHPRONËSUARVE "PRONËSI ME DREJTËSI", e përfaqësuar nga avokati Agim Tartari, me prokurë .

2. KUVENDI I SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga këshilltari juridik, Viktor Gumi, me autorizim .

3. KËSHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga juristi Sokol Shazi, me autorizim .

OBJEKTI: Shfuqizimin e nenit 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", pasi vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe me vetë ligjin

BAZA LIGJORE: Neni 131 gërma "a" e Kushtetutës .

Në kërkesën e saj Shoqata "Barazi para Ligjit" parashtroi këto shkaqe:

- Gabimet që janë bërë nga shteti totalitar, duhet të përballohen nga vetë shteti dhe nuk mund të korrigjohen duke bërë gabime të reja . Të drejtat e fituara në mënyrë të ligjshme në kohën e monizmit, nuk janë prekur .

- Shteti e kthen pronën kur ajo ekziston dhe është në pronësi të shtetit dhe jo kur është fituar nga persona të tjerë në bazë të një veprimi juridik të ligjshëm.

- Neni 10 i ligjit vjen në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës, sepse i merr personit pronën për t'ia kthyer një tjetri dhe jo për interesa publike .

- Neni 10 i ligjit prish në mënyrë të njëanshme marrëdhëniet juridike, veprim ky në kundërshtim me Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut .

- Nuk rezultojnë asnjë rrethanë që të vërtetojë keqbesimin e personave në blerjen e ndërtesave nga shteti, përkundrazi, i kanë mirëmbajtur dhe transformuar duke bërë shpenzime të mëdha që nuk merren parasysh nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993.

- Kompensimi që jepet nga shteti për këto ndërtesa, është absolutisht i papranueshëm dhe diskriminues. Shuma që jep shteti është e pamjaftueshme për të blerë shtëpi tjetër, kështu që familjeve që u merret ndërtesa, do të kalojnë në kushtet e varfërisë së plotë.

Pala kërkuese, gjatë gjykimit të çështjes dhe në përfundim të saj, ndryshoi objektin e kërkesës, duke kërkuar jo ndryshimin e nenit 10, por shfuqizimin e tij dhe në eventualitetin që do të çmohet i drejtë kthimi i pronës ish-pronarëve, të shfuqizohet ajo pjesë e nenit 10 paragrafi i I-rë, për të mundësuar, që personat e tretë të shpërblehen me vlerën e plotë të ndërtesës.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi përfaqësuesin e Shoqatës "Barazi para Ligjit", që kërkoi pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e Kuvedit dhe të Këshillit të Ministrave, që gjithashtu u shprehën për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve "Pronësi me Drejtësi", që kërkoi rrëzimin e kërkesës si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN

Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve "Pronësi me Drejtësi", kërkoi rrëzimin e kërkesës me argumentin se ndodhemi para gjësë së gjykuar, sepse çështja e kushtetutshmërisë së nenit 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, është shqyrtuar një herë nga gjykata Kushtetuese. Ky pretendim i ngritur nuk është i bazuar. Është e vërtetë se Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 9, datë 30.11.1994 të saj është shprehur për kushtetutshmërinë e nenit 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 " Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", mbi kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe për shkaqet e paraqitura, e ka rrëzuar këtë kërkesë. Por, ky fakt nuk do të thotë se jemi para gjësë së gjykuar. Megjithatë rregullat e gjësë së gjykuar vlejné edhe për Gjykatën Kushtetuese, kjo e fundit është e detyruar të marrë në shqyrtim çdo çështje me të njëjtin objekt, pavarësisht se është shqyrtuar më parë, kur ndryshojné subjektet dhe shkaqet e parashtuara dhe në

rrethanat kur kërkesa është rrëzuar. Në rastin konkret, jo vetëm ka ndryshuar subjekti që është Shoqata "Barazi para Ligjit", por edhe shkaqet që kjo ka paraqitur për shfuqizimin e nenit 10 janë të tjera dhe shumë më të gjëra. Pra, duke ndryshuar subjekti dhe shkaku, Gjykata Kushtetuese nuk ka pengesë për të marrë në shqyrtim kërkesën e Shoqatës "Barazi para Ligjit".

Në paragrafin e parë të nenit 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", është bërë rregullimi i problemit të ndërtesave të ish-pronarëve që janë tjetërsuar në persona të tretë. Ligjvënësi ka vendosur që këto ndërtesa t'u kthehen ish-pronarëve, ndërsa personat e tretë do të marrin masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit e konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve. Me këtë zgjidhje, ligjvënësi është përpjekur që të harmonizojë interesat e këtyre dy kategori personash, duke i dhënë përparësi ish-pronarëve me qëllim që prona të kthehet në origjinën e saj, ndërsa blerësit, të cilët janë bërë pronarë mbi bazën e kontratave të shitblerjes, ku shitës ka qënë shteti i asaj periudhe, do të marrin shpërblimin për këto ndërtesa.

Ky qëndrim i ligjvënësit, përse i përket kthimit të pronës në origjinën e saj, dmth., tek ish-pronarët apo trashëgimtarët e tyre, nuk mund të merret i shkëputur dhe as mund të kuptohet i veçuar me vetë qëllimin e nenit 1 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", ashtu edhe me vetë frymën e këtij ligji, që në tërësinë e tij synon të rregullojë, për aq sa është e mundur, padrejtësitë e bëra shtetasve të cilët u zhveshën në mënyrë të padrejtë nga pronësia, nëpërmjet shtetëzimeve, konfiskimeve, shpronësimeve dhe me çdo mënyrë tjetër, për periudhën nga 29 nëntori 1944 e më pas. Edhe Kushtetuta, me detyrimet që përmend në nenin 181 të saj, që për një periudhë 2-3 vjeçare të nxirren ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet e konfiskimet e kryera para miratimit të Kushtetutës, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 144 të saj, nënkupton angazhimin për një rregullim më të mirë të këtyre çështjeve, gjithnjë në interes të të shpronësuarve dhe të konfiskuarve. Prandaj, edhe vetë tendenca e legjislacionit të periudhës pas vendosjes së pluralizmit në Shqipëri, është orientuar nga mbrojtja e interesave të ish-pronarëve për të minimizuar padrejtësitë e bëra ndaj tyre nga shteti totalitar.

Duke e parë problemin në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pjesa e parë e dispozitës së nenit 10 paragrafi i I-rë, që ligjëron kthimin e ndërtesave ish-pronarëve, nuk vjen në kundërshtim as me dispozitat kryesore kushtetuese që kanë qënë në fuqi në kohën e daljes së ligjit, as edhe me Kushtetutën. Duke vepruar në këtë mënyrë, shteti nuk është se ka marrë nëpër këmbë të drejtat e ligjshme të personave të tretë dhe as i ka nënvleftësuar ata, por përkundrazi, i ka marrë në konsideratë dhe ka marrë përparësi detyrimin që, për të ballancuar interesat dhe për të mos krijuar padrejtësi të reja, kategoria e personave të tretë të kompensohet duke marrë shpërblimin përkatës. Mirëpo, ndërsa kjo vëmendje e shtetit për të shpërblyer personat e tretë nuk ka munguar, mënyra se si është zgjidhur kjo çështje nga neni 10 paragrafi i I-rë, nuk është në përputhje me Kushtetutën. Duke u shpërblyer personat e tretë me çmimin e blerjes të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, ligji nuk i ka vënë këto dy kategori personash në një shesh barazie, përkundrazi, kategoria e personave të tretë është vënë në pozita pabarazie dhe diskriminuese, gjë që pas sjell pamundësinë e saj të hyjë në qarkullimin civil për të siguruar një banesë tjetër. Rregulli për masën e shpërblimit, sipas nenit 10 paragrafi i I-rë (çmimi në kohën e blerjes i konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, kur ky indeksim do të llogaritet sipas nenit 27 të ligjit në momentin e hyrjes në fuqi të tij), vjen në kundërshtim me parimin e barazisë dhe pikërisht për këtë shkak, kjo pjesë e nenit 10, duhet të shfuqizohet si antikushtetuese. Aq sa është e drejtë dhe kushtetuese kthimi i pronave ish-pronarëve, po aq e drejtë dhe kushtetuese është sigurimi nga shteti i një shpërblimi të drejtë dhe të plotë të personave të tretë, duke marrë për bazë çmimin e tregut dmth., vlerën reale që ka ndërtesa në momentin e dorëzimit tek ish-pronari. Kjo zgjidhje, nga njëra anë nuk lejon të preken interesat e personave të tretë dhe nga ana tjetër nuk lejon sigurimin e përfitimeve pasurore të papërligjura, sepse secili do të shpërblehet për aq sa i takon kundrejt objektit që dorëzon, duke marrë në konsideratë edhe shpenzimet e bëra nga personat e tretë për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e ndërtesave.

Nga shpjegimet që dha pala kërkuese dhe subjektet e interesuara, në zbatim të nenit 10 të

ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, në bazë të vendimeve të komisionit të kthimit të pronave apo të vendimeve gjyqësore, nga pikëpamja juridike, këto ndërtesa përgjithësisht kanë kaluar në pronësi të ish-pronarëve, ndërsa faktikisht, mbahen nga personat e tretë, që janë shndërruar në qiramarrës ndaj ish-pronarëve. Përderisa ka kaluar e drejta e pronësisë, kërkesa për shfuqizimin në tërësi të nenit 10 paragrafi i I-rë, me qëllim që ndërtesat t'u mbeten personave të tretë ndërsa ish-pronarët të kompensohen, ashtu siç kërkon Shoqata "Barazi para Ligjit", është kontradiktore dhe e papranueshme, sepse pas shfuqizimit, organi ligjvënës i sotëm për të plotësuar boshllëkun ligjor do të detyrohej që të bënte të njëjtin veprim që bëri organi ligjvënës në vitin 1993, dmth., të transferonte me ligj pronësinë nga ish-pronarët tek pronarët e tretë, pra shteti edhe pa qënë pronar i këtyre pronave do të prishte në mënyrë të njëanshme marrëdhëniet juridike të krijuara sipas ligjit të vitit 1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". Kështu që ajo që nuk pranohet si kushtetuese për atë kohë, sipas shkaqeve të paraqitura në kërkesë nga Shoqata, nuk mund të jetë kushtetuese sot po për të njëjtat shkaqe.

Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e shoqatës "Barazi para Ligjit" duhet pranuar pjesërisht, duke shfuqizuar atë pjesë të nenit 10 paragrafi i I-rë të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 që ka të bëjë me masën e shpërblimit për ndërtesat ish-pronë private që janë tjetërsuar nga persona të tretë. Duke bërë këtë shfuqizim, i takon organit që ka iniciativën ligjvënëse dhe organit ligjvënës, që në përputhje me përmbajtjen e këtij vendimi, të bëjnë plotësimet përkatëse të dispozitës së nenit 10 paragrafi i I-rë të ligjit të sipërcituar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 "a" të Kushtetutës dhe nenit 41 të ligjit nr. 8373, datë 15.07.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

Të shfuqizojë si të papajtueshme me Kushtetutën, frazën që përmban neni 10 paragrafi i I-rë i ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", me përmbajtjen: "... ndërsa personave të tretë shteti u kthen masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit, e konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve".

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 21.03.2000

Nr. 56/1 i Regj. Themeltar.

Nr. 12 i Vendimit

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa e Shoqatës "Barazi para Ligjit" duhet të pranohet dhe neni 10 i ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", duhet të shfuqizohet si i papajtueshëm me Kushtetutën sepse:

Ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 " Për dispozitat kryesore Kushtetuese" me gjithë shtesat përkatëse në përmbajtjen e vet nuk pranon ndërprerjen e rendit juridik me rastin e ndërrimit të sistemeve, regjimeve apo qeverive. Si rrjedhojë, prona që qytetarët kanë fituar sipas ligjit para vitit 1991, nuk duhet t'u preket.

Është e vërtetë që pas vitit 1944 u bënë shumë marrje të padrejta të pronës. Korrigjimi i gabimeve duhet të bëhet, por gjithmonë aty ku shteti e zotëron vetë pronën, pra kur ka mundësi t'i

kthejë. Kur nuk e ka në pronësi të vet, duhet t'ua kompensojë ish-pronarëve sipas mënyrave të parashikuara në ligj. Dhe për korrigjimin e padrejtësive të bëra për pronën në periudhën para vitit 1991, shteti shqiptar mori disa masa. Së pari, përcaktoi me ligje e akte të tjera normative kalimin pjesë-pjesë të pronës shtetërore në private dhe së dyti, nëpërmjet ligjit nr. 7698, datë 10.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", etj., mori masa për korrigjimin e gabimeve të bëra ndaj individëve të ndryshëm, të cilëve u ishte marrë prona në mënyrë të padrejtë. Por, ndërsa tjetërsimet e masat e tjera të marra për pronën shtetërore, ishin në kompetencën e vet, nuk mund të jepet i njëjti vlerësim për pronën që nuk ishte e shtetit, por e qytetarit. Këtë të fundit, shteti nuk ka të drejtë ta disponojë.

Sipas legjislacionit të mëparshëm, ishte e ligjshme kalimi i pronësisë me anën e shitblerjes, trashëgimisë etj. Këto mënyra kalimi, parashikohen edhe në nenin 41 të Kushtetutës në fuqi, sipas të cilës: "Prona fitohet me dhurim, me trashëgim, me blerje dhe çdo mënyrë tjetër klasike, të parashikuar në Kodin Civil". Duke qënë kështu, nuk mund të konsiderohet e pavlefshme blerja e shtëpive të banimit nga qytetarët në periudhat 1945-1990, aq më tepër që sipas nenit 8 të ligjit nr. 7491, datë 29.04.1991, zbatimi i përpiktë dhe i njëjlojtë i normave juridike, është i detyrueshëm për të gjitha organet shtetërore... personat fizikë e juridikë. Në nenin 27/2 të ligjit 7692, datë 31.03.1993 për " Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut", ndërsa pranohet se askujt nuk mund t'i mohohet e drejta të ketë pronën private, përcaktohet edhe se: "Fitimi, gëzimi dhe tjetërsimi i pronës... rregullohen me ligj". Pikërisht, në bazë të ligjit, pronarët e rinj, kanë fituar shtëpitë e banimit dhe kjo e drejtë nuk mund t'u mohohet.

- Duke qënë pronarë të ligjshëm, pronarëve të rinj mund t'u merret prona vetëm në rastet e parashikuara në ligjet themelore të shtetit. Por, si ligji "Për dispozitat kryesore kushtetuese", në nenin 27/3 ashtu edhe Kushtetuta në fuqi, e kanë të shprehur qartë se shpronësimi ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës, mund të parashikohen vetëm për interes publik. Marrja nga një pronar e dhënia tjetrit, nuk është interes publik, por vetiak.

- Marrja e pronës nëpërmjet nenit 10 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", vjen në kundërshtim me Konventën Europiane "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", e cila përcakton që: " Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, veçse për arsye të dobisë publike". Ndërsa ligji "Për dispozitat kryesore kushtetuese", shpallte në nenin 8, se legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, njeh dhe respekton parimet dhe normat përgjithësisht pranuar të së Drejtës Ndërkombëtare, Kushtetuta në fuqi, në hierarkinë e normave, i vendos marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, para ligjeve, duke theksuar në nenin 122/2, që një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj (siç është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut), ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

Duke u marrë qytetarëve pronën e fituar me kontrata të ligjshme, në kohën e lidhjes së tyre, pushteti legjislativ, futet në kompetencat e pushtetit gjyqësor, pra cënon parimin e ndarjes së pushteteve, aq më tepër që pronarët e rinj nuk kanë asnjë lloj përgjegjësie për marrjen e pronave nga shteti i asaj kohe.

Ata, kanë qënë në mirëbesim kur lidhën kontratat e shitblerjes për interes të tyre.

Referimi i shumicës tek neni 181/1 i Kushtetutës në fuqi, për të mospranuar kërkesën e Shoqatës " Barazi para Ligjit", nuk është i drejtë. Vetë neni 181, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit për të nxjerrë ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të Kushtetutës, përcakton njëkohësisht që ky rregullim do të bëhet duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41 të Kushtetutës. Ky nen, ndërsa garanton të drejtën e pronës private njeh fitimin e pronës me kontrata, me trashëgimi e në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në Kodin Civil, lejon shpronësimin ose kufizimin vetëm për interes publik dhe vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

A N Ë T A R
S. Sadushi

A N Ë T A R
K. Puto

U dorëzua për shtyp më 18.5.2000
Doli nga shtypi më 19.5.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 150 lekë